

RAPORTI VJETOR
2017

I INFORMACION MBI
KOMPANINË

II OPERACIONET,
THESARI DHË
NJË RISHIKIM
FINANCIAR

III GOVERNANCA

IV BURIMET
NJERËZORE

V PËRGJEGJËSIA
SOCIALE

VI RAPORTI I
AUDITORËVE

MALTIN KORKUTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

I

MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHEM EKZEKUTIV

Credins bank e mbylli vitin 2017 me tregues financiarë në rritje dhe vazhdoi të punojë me vision dhe në përputhje me objektivat strategjike për fuqizimin e stafit, të klientëve dhe të aksionerëve duke konsoliduar pozicionin e saj në treg. Banka punoi me intensitet për të forcuar strukturën e zhvillimit të biznesit dhe rrjetin e degëve, të shoqëruar me vendimarrje për ngritjen e infrastruktures teknologjike dhe dixhitale, që i paraprin kërkesave në rritje për fuqizimin e rolit të bankës në sektorin retail. Gjatë 2017 u investua në mënyrë të kujdesshme e në respekt të parametrave të riskut si në sektorin e korporatave dhe në atë mikro, agro e individë në përputhje me nevojat e klientëve aktuale dhe atyre potencialë. Përfundimi i disa projekteve në fushën teknologjike dhe krijimi i strukturave që i shërbejnë optimizimit të zgjidhjeve teknologjike që do të implementohen në 2018 hap një perspektive të shkëlqyer për ndërveprim në rritje me klientet përmes kanaleve alternative. Brandi Credins përfaqëson një emër të fuqishëm dhe të besueshëm, i krijuar për tu bërë zgjedhja numër një për shqiptarët.

Konteksti ekonomik global dhe vendas gjatë vitit 2017 ishte kompleks dhe me sfida të shumta, përfshirë kërkesat rregullatore në rritje, luhatjet në tregun e këmbimeve valutore, por përtej këtyre vështirësive Credins bank konfirmoi pozicionimin e saj si banka e dytë në vend për kredidhënie, dhe banka e tretë më e madhe në vend në depozita dhe aktive. Viti 2017 përkoi me fundin e planit trevjeçar të zhvillimit të Bankës dhe përgatitjen e startegjisë për tre vitet e ardhshme. Credins ka siguruar një rritje të qëndrueshme

në të ardhura, shtrirje kapilare në të gjithë vendin, por dhe ka amplifikuar prezencën e saj pranë qytetarëve, klientë e jo klientë përmes marrëveshjeve të rëndësishme me institucionet qendrore dhe lokale, për lehtësimin e aksesit në shërbimet financiare për të gjitha kategoritë e popullsisë nga student në pensionistë.

Gjatë 2017 u hap një degë e re në Lezhë dhe u investua në shkallë të gjerë në rivitalizimin, zgjerimin dhe përmirësimin e infrastruktures së degëve ekzistuese duke krijuar kushte optimale për një shërbim sa më efektiv ndaj klientëve. Investimi i bërë në kapitalin njerëzor, përmes programit të trajnimit të stafit për efektivitetin e shitjeve (SFE), nuk është një ndërhyrje rastësore, por përbën kulturën e re të punës, stilin e menaxhimit, dhe marrëdhënien gjithnjë e më proaktiv të punonjësve ndaj klientit.

Cilësia kredive dhe qendrueshmeria e depozitave ishte fokusi ynë kryesor, dhe kjo është reflektuar në ritmin e rritjes së tyre në 2017. Sot, Credins ofron një gamë të plotë produktesh që iu përgjigjen kërkesave në rritje të individit, institucioneve apo biznesit. Përvëc produkteve të tjera, gjatë 2017 risi ishte hedhja në treg e Mastercard për biznesin në EUR dhe USD si kartë debiti dhe krediti, si dhe Mastercard Gold për klientët Elitë në Credins. Credins bank si një nga bankat përmes së cilës mundësohen pagesat përmes portalit e-Albania, vazhdoi të jetë pjesë dinamike e përmirësimeve të platformave të pagesave.

Credins, renditet si një nga mbështetësit më

të mëdhenj në fushën e përgjegjësisë sociale duke kontribuar përmes donacioneve dhe sponsorizimeve në shumë aspekte sociale, infrastrukturore, institucionale, kulturore dhe në ambient. Prej dy vitesh, Credins bank i është bashkëlidhur iniciativës së Shoqatës Shqiptare të Bankave për të prezantuar së bashku me raportin e përgjegjësisë sociale dhe kontributin që jep në përmbushjen e Objektivave për një Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG) të Kombeve të Bashkuara

Në 2017, Credins bank, vazhdoi të forcojë strukturat e saj të auditimit të brendshëm dhe përpuethshmërisë për t'ju përgjigjur sa më mirë kërkesave rregullatore në rritje për këto fusha në sistemin bankar. Burimet Njerezore dhe fuqizimi i njerezve, ka qenë gjithashtu një nga prioritetet e vitit. Gjate 2017, banka përmirësoi ndjeshëm politikat e brendshme për rekrutimin dhe vlerësimin e stafit, përcaktimin e indikatorëve për performacen dhe të gjitha këto u shoqëruan me një plan intensiv trajnimesh si dhe me një paketë financiare inicentivash.

Vitin 2018, Credins bank do t'ja kushtojë teknologjisë, një akselerator i fuqishëm i jetes ekonomike të individit dhe biznesit. Përmirësimi i proceseve për lehtësimin e aksesit të klientit në produktet dhe platformat teknologjike do të shoqërohet me zgjerimin e gamës së produkteve tradicionale dhe aksesimit të tyre përmes kanaleve të reja teknologjike si dhe me shfrytëzimin e teknologjisë si një mënyrë për të menaxhuar me efikasitet kostot. Banka ka diversifikuar me tej operacionet e veta duke marrë licensën e Brokerit nga AMF dhe synojmë që ky aktivitet i ri të fillojë

të japë rezultatet e para në gjysmën e dytë të 2018.


Ne mbetemi të ndergjegjshëm për rolin kyc që mbajmë në zhvillimin e shoqërisë dhe përmes objektivave që kemi përcaktuar në planin e ri strategjik trevjeçar synojmë që përveç rritjes së qëndrueshme të vetë bankës, të japim kontributin tonë në krijimin dhe mirëmenaxhimin e mirëqenies dhe rritjes së qëndrueshme të klienteve tanë, të stafit dhe mbi të gjithë të aksionarëve tanë që na mbështesin me besim në këtë rrugëtim të suksesshem.

Sinqerisht

Maltin KORKUTI
Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv



RAJONI TIRANË



HUADHËNIA

71.6%
TË PORTOFOLIT
TË BANKËS

DEPOZITA

47.5%
TË PORTOFOLIT
TË BANKËS

134,243

KLIENTË

BANKA CREDINS NË 2017



DIVIZIONI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT

Edhe gjatë vitit 2017, Banka i qëndroi konsekuente politikës së saj për uljen graduale të portfolit të korporatave në favor të zhvillimi më dinamik të sektorit retail. Departamenti i Korporatave u fokusua në menaxhimin e kujdesshëm të klientëve korporata, por dhe shitjen e kryqezuar të produkteve të bankës

Në mars 2017 filloi implementi i standardeve SFE në rrjetin e degëve dhe ky moment shënoi edhe fillimin e riorganizimit të strukturave të brendshme me funksionin kryesor: nxitjen, suportin, kontrollin, vlerësimin dhe përmirësimin e procesit shitës në çdo degë të bankës.


Produktet në fokus kanë qenë depozitat dhe obligacionet e bankës, të cilat së bashku janë realizuar në 100.74% të buxhetit për depozitat, ndërsa vetëm rritja neto e depozitave është 102.27% e buxhetit. Ndërkohë që sistemi bankar për këtë produkt është rritur me 0.43% deri në Nëntor 2017, Credins bank është rritur me 5.05%.

Portofoli i kredisë gjeneruar nga rrjeti i degëve është rritur me 10% në krahasim me fundvitin 2016 duke shkuar në rreth 31.3 mld lek ndërkohë që sistemi bankar e ka rritur kredidhënien vetëm me 1% krahasuar me vitin e kaluar.

16.7%
RRITJA E DEPOZITAVE INDIVIDE



TOTAL DEPOZITAVE SIPAS LLOJIT TË MATURITETEVE



- Llogari Rrjedhese
- Depozita 12 Mujore
- Depozita Pa Afat
- Depozita 24 Mujore
- Depozita 1 Mujore
- Depozita 36 - 48 Mujore
- Depozita 3 Mujore
- Depozita 60 Mujore
- Depozita 6 Mujore
- Llogari Te Tjera

Këtë vit rezultojnë një rritje e komisioneve me rreth 32.7% krahasuar me vitin e kaluar, rritje e cila është vërtetuar në gjithë rajonet e bankës. Të ardhura që rezultojnë nga komisionet e gjeneruara nga POS, Karta, rritje transfertash dhe komisionesh si dhe rritje e transaksioneve Cash.

Gjatë vitit 2018 prioritetet strategjike për rrjetin e degëve mbeten ruajtja e avantazhit konkurrues të cilësisë së lartë të shërbimit ndaj klientelës, automatizimi i proceseve manuale në degë – në bashkëpunim me Divizionin Operacional, vazhdimi i rritjes së shitjes së kryqëzuar në degë si përsa i përket produkteve tona ashtu edhe produkteve të kompanive partnere si Fondi i pensionit dhe Credins Invest etj., pasurimi i veprimtarisë së analistit të kredisë në analist shitjeje i cili do të aftësohet më tej për shitjen dhe procesimin e të gjitha produkteve që ofron banka.

Gjatë 2017, objektivi për rritjen e tepërcës së portfolit leasing ishte shtimi me 16% ndaj vitit 2016

dhe ky objektivi u arrit në masen 99.5%. Rritja në shitjen e produktit leasing ka ardhur si rezultat i një sërë faktorësh të cilët analizohen më tej.

Banka ka diversifikuar portofolin e saj në koncensionarët më të rëndësishëm në vend. Njëkohësisht, është vënë një theks i veçantë në shitjen e produktit leasing edhe në rrjetin e degëve të bankës, gjë që gjatë vitit 2017 ka sjellë një kontribut prej 12%. Për vitin 2018, parashikohet një rritje e tepricës me 11% krahasuar me vitin 2017. Gjithashtu, gjatë vitit 2018 parashikohen të shtohen karakteristikat për produktin leasing duke arritur aplikimin e kërkesave të klienteve për të zgjeruar gamën e mjeteve që financohen me këtë produkt si: autobuse, kamiona, makineri të rënda, etj.

DIVIZIONI I OPERACIONEVE

Departamenti Operacional, si struktura qendrore në mbështetje të procesimit korrekt dhe në kohë të të gjithë veprimeve në rrjetin e Bankës, vazhdoi edhe përgjatë 2017 të përmbushë me profesionalizëm dhe efektivitet rolin e tij, duke kontribuar në rritjen e vazhdueshme të volumeve të transaksioneve të pagesave dhe instrumentave të Trade Finance.

Credins Bank, përgjatë vitit 2017, ka procesuar në kohë reale nëpërmjet sistemeve AIPS dhe AECH një fluks të konsiderueshëm të transfertave në nisje në monedhën kombëtare, me një rritje prej 28% në vlerë, dhe 11% në numër transaksionesh, krahasuar me vitin 2016. Transfertat në mbërritje, në monedhën kombëtare, kanë një rritje prej 16%, në vlerë dhe 12% në numër transaksionesh. Transfertat në monedhë të huaj, shënuan gjithashtu rritje, duke reflektuar vlerat si më poshtë. Kështu transfertat në nisje monedhë të huaj, shënuan një tregues me një rritje prej rreth 10% në vlerë dhe në numër transaksionesh, ndërkohë që transfertat në mbërritje në valutë, me një rritje prej 1.5% në vlerë, dhe 41% në numër transaksionesh, krahasuar me vitin 2016.

Si rrjedhojë e këtyre volumeve, komisionet nga shërbimi transfertave, brenda dhe jashtë vendit, shënuan një rritje prej rreth 19%, krahasuar me vitin 2016.

Pagesat nëpërmjet e-banking, po ashtu shënuan

rritje në numër transaksionesh rreth 42%, dhe të vlerës së komisioneve rreth 27%, krahasuar me vitin 2016.

Instrumentat e Trade Finance si Letër-kreditë, Garancitë me jashtë dhe Incaso-t, patën një rritje të komisioneve me rreth 8.3% krahasuar me vitin 2016.


Gjithashtu, tregues të kënaqshëm janë shënuar në fushën e pagesave utilitare me rritje të komisioneve gati dy-herë më shumë se ato të shënuara në vitin 2016.

Pagesat e Tatimeve dhe Doganave, po ashtu u rritën me rreth 28%, në vlerë, 59% në numër transaksionesh dhe 41% në vlerë të komisioneve. Credins Bank është një nga bankat kryesore në vend për shërbimin e procesimit të Pagave për kompanitë dhe institucionet shtetërore. Përgjatë vitit 2017, ky shërbim vijoi të shenojë një rritje prej rreth 3%, krahasuar me vitin 2016.

Po ashtu, vlen të përmendet finalizimi i marrëveshjes me ISSH për procesimin e Pensioneve nëpërmjet Bankës, ku Departamenti Operacional pati një rol shumë aktiv e gjithëpërfshirës, në hartimin dhe implementimin e procedurave përkatëse të dakortësuara për procesimin e Pensioneve.

Kartat Përfundimi me sukses i projektit të anëtarësimit në Mastercard, shënoi një hap tjetër

HUADHENIA SIPAS INDUSTRIVE NE SEKTORIN KORPORATE



- Industria Nxjerrëse
- Industria Perpunuese
- Ndertimi
- Tregtia
- Hotele Dhe Restorante
- Pasuri Te Patundshme
- Arsimi
- Shendeti Dhe Veprimtari Sociale
- Sherbime Kollective, Sociale
- Media

të rëndësishëm në përmbushjen e angazhimeve tona për të ofruar një portofol të plotë produktesh dhe shërbimesh të kartave për të gjitha kategoritë e klientëve. Për të mbështetur biznesin dhe për t'ju përgjigjur kërkesave gjithmonë në rritje të klientëve, në 2017 Credins Bank ka qenë prezente në tregun bankar me produkte dhe shërbime cilësore, duke ofruar karta Visa dhe Mastercard debiti dhe krediti për individë, biznese dhe institucione publike në Lek dhe monedhë të huaj. Banka Credins ka qenë e para bankë në vend që ka ofruar karta Visa të parapaguara në Lek edhe për individë jo klientë të bankës. Duke patur parasysh treguesit dhe kërkesat për këto produkte, në 2017 banka mundësoi lëshimin e kartave të parapaguara edhe në monedhë të huaj, duke plotësuar kështu nevojat për veprime cash, blerje në POS dhe blerje të sigurta online, jo vetëm në Lek.

Me një portofol të plotë produktesh dhe shërbimesh dhe me tregues sasiore dhe cilësore gjithmonë në rritje, aktiviteti i kartave mund të konsiderohet i maturuar. Qëllimi ynë në 2017 dhe në vazhdim ka qenë dhe mbetet implementimi dhe perfeksionimi i teknologjive të reja, përmirësimi i elementeve të sigurisë në lëshimin dhe pranimin e kartave, zbatimi i skemave të besnikërisë, etj. Kartat Mastercard janë të teknologjisë contactless, të thjeshta, komode dhe të sigurta në përdorim. Përgjatë vitit 2017 janë instaluar terminale të reja POS contactless dhe është në proces përshtatja e terminaleve ekzistues për të pranuar pagesa me karta contactless.

Pjesë e projektit me Mastercard, kanë qenë edhe produktet World, që do të jenë të parët të kësaj natyre në tregun bankar shqiptar, nëpërmjet të cilëve klientët do të përfitojnë benefite shtesë si sigurim jete në udhëtim, asistencë, ofrimi i shërbimit të zëvendësimit të kartës në rast emergjence, skemë besnikërie, etc. Gjithashtu karta Mastercard Gold, konceptuar dhe lëshuar për kategorinë e klientëve Elitë, përbën një tjetër arritje në përpjekjen tonë për të qenë të pranishëm me një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh të kartave.

Sipas raportit të Visa International, Banka Credins ka performuar mbi mesataren e tregut, me një rritje 41% krahasur me rritjen 33% të tregut. Krahasuar me 2016 duket qartë përmirësimi i pjesës më të madhe të treguesve sasiore dhe cilësore, jo vetëm si lëshues, por edhe si pranues të transaksioneve me kartë. Ajo që bie në sy është përmirësimi i dukshëm i treguesve cilësorë të përdorimit të kartave dhe terminaleve Credins, kjo krahasuar me një vit

më parë, por edhe në raport me tregun bankar shqiptar.

Treguesit cilësorë që lidhen me efikasitetin e përdorimit të kartës, si: numri i transaksioneve në vit për 1 kartë; volumi i blerjeve në vit për një kartë dhe mesatarja e një blerje, janë më të larta krahasuar me tregun. Gjithashtu edhe treguesi i kartave aktive në raport me kartat në total është përmirësuar krahasuar me vitin 2016. Mesatarisht numri i kartave aktive sipas raporteve të Visa është rritur me 16%.

Vazhdojnë të jenë të lartë të gjithë treguesit e lëshimit dhe përdorimit të kartave të parapaguara. Kartat e parapaguara rezultuan një risi e suksesshme në tregun shqiptar, dhe ecuria pozitive përtej parashikimeve edhe e kartave të parapaguara Mastercard në Euro, e vërteton më së miri këtë. Lëshimi i kartave Mastercard Prepaid në Euro ka sjellë një rritje të ndjeshme të aktivitetit on-line me këto karta.

Kartat Visa Business për Institucionet Publike, mbetet një nga zgjidhjet më të suksesshme që Credins Bank ofron. Gjatë 2017 është rritur jo vetëm numri i Institucioneve Publike që operojnë me Credins Bank, por edhe gjithë treguesit e përdorimit të këtyre kartave. Sipas raporteve të Visa dhe Mastercard, edhe treguesit si Acquiring – pranimi në терминалет Credins i transaksioneve me karta Visa dhe Mastercard, kanë shënuar rritje mbi mesataren e tregut në numër, dhe veçanërisht në volum transaksionesh.

Në fokus për vitin 2018 do të vazhdojë të mbetet rritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i të gjithë treguesve të aktivitetit të kartave, në numër dhe volum transaksionesh edhe si lëshues, edhe si pranues të kartave Visa dhe Mastercard. Shtimi i një brandi të ri prestigjioz si Mastercard dhe pranimi i valutave Euro nga терминалет Credins, parashikohet të sjellë rritje të kërkesës nga ana e tregtareve për paisjen me to. Implementimi i teknologjive të reja në fushën e pagesave elektronike, të përshtatura sipas nevojave të klientit dhe të çdo individi joklient të bankës, ka qenë dhe vazhdon të mbetet sfida dhe synimi ynë kryesor.

IT - “DataWarehouse” Dhe “business intelligence”

Gjatë vitit 2017, ashtu siç ishte planifikuar filloi gjenerimi i raporteve të para në përputhje me nevojat e identifikuara gjatë analizës. Gjithashtu ka vazhduar puna intensive për një numër të madh projektesh për të cilët pilotimin e ndërfaqes Jeniux në degë, përmirësimi i modulit të pagesave

për e-Banking, testimet dhe përditësimet lidhur me Mastercard, në monedhat lek dhe USD. Implementimi i marrëveshjes me ISSH për automatizimin e kalimit të pensioneve përmes Bankës duke përdorur portalin e ISSH, rritje e komunikimit të institucioneve publike përmes portalit e-albania. Departamenti i IT ka vazhduar të jetë një nga shtyllat kryesore mbështetëse në plotësimin e kërkesave për infrastrukturën e nevojshme dhe efektive për realizimin e projekteve të ndërmarra gjatë këtij viti, për gjenerimin dhe sigurimin e bazës së nevojshme me të dhëna që ndihmojnë vendimarrjen e përditshme të të gjithë departamenteve, trajnimin e stafit mbi praktikën më të mira për përdorimin e sistemeve bankare, etj. Gjatë këtij viti indikatorë të rëndësishëm që janë monitoruar tregojnë se disponueshmëria e komunikimit me degët ka qenë 98.986% ndërsa disponueshmëria e ATM-ve ka qenë 98.863%.

Departamenti i Thesarit Tregjet Financiare paraqesin dinamika të forta në çdo periudhë dhe ndikojnë ndjeshëm raportet e kompanive, ekonominë e një vendi dhe situatën ekonomike të individit. Departamenti i Thesarit në Bankën Credins, pavarësisht sfidave në tregjet financiare përgjatë vitit 2017, ka arritur të menaxhojë me efektivitet likuiditetin e Bankës duke minimizuar impaktin negativ ndaj risqeve të paraqitura, dhe duke mbështetur në qëndrueshmërinë e tregut Bankar vendas. Planifikimi dhe menaxhimi me seriozitet dhe profesionalizëm i çdo investimi të kryer ka ofruar mbështetje në aktivitetin kryesor të Bankës.


Profesionalizmi i fituar nga përgatitja dhe eksperiencia, si edhe nga trajnimet periodike të punonjësve në Departamentin e Thesarit, janë pasqyruar në rezultatet pozitive që janë arritur për Bankën gjatë vitit 2017 në sektorin e investimit të likuiditetit. Përdorimi i instrumentave financiarë në tregun bankar vendas në bashkëpunim me bankat rezidente ka sjell stabilitet dhe përfitueshmëri për Bankën, si dhe ka ofruar zhvillim të tregut për sa i përket marrëdhënieve ndërbankare dhe ulje të kostove për produktet e Thesarit. Rritja e ndjeshme në volumet e këmbimit valutor për vitin 2017 ka zgjeruar ndjeshëm marrëdhënien e bashkëpunimit të Bankës me bankat jorezidente duke sjell rritje të besueshmërisë dhe ulje të kostove të tregtimit në tregjet valutore globale. Banka është pozicionuar si leader në tregun financiar vendas, pikërisht duke ofruar klientëve

mundësinë e tregtimit valutor përgjatë 24 orëve dhe gamën e monedhave dytësore, të cilat kanë ndihmuar në përfitueshmëri më të lartë për vitin 2017. Volumet e këmbimeve valutore sidomos në monedhat dytësore AUD, CAD, JPY janë rritur ndjeshëm përgjatë vitit 2017, duke i kthyer këto monedha ndër më të preferuarat për investitorët shqiptarë. Në këtë kuadër, një ndër objektivat e Departamentit të Thesarit është mundësia e kryerjes së këmbimeve apo pagesave në monedhën kineze, për ato kompani që kryejnë transaksione me Kinën.

Menaxhimi i likuiditetit për qarkullimin e fondeve fizike për degët e Bankës ka qenë një nga sfidat e Departamentit përgjatë vitit 2017. Furnizimi i degëve në kohë dhe me fonde të mjaftueshme ka sjell rritje të bashkëpunimit me klient subjekte dhe individë. Përmeshja në kohë, dhe me kosto më të ulët për Bankën, e kërkesave të klientëve për fonde cash ka sjell rritje të besueshmërisë edhe bashkëpunimit.

Gjithashtu, Banka Credins është angazhuar në tregtimin e letrave me vlerë në tregun sekondar duke zgjeruar bazën e klientëve që shërben, duke suportuar klientët në investimet e tyre me kosto më të ulët dhe shërbim transparent dhe cilësor. Viti 2017, rezultoi një vit i suksesshëm në emetimin e obligacioneve të Credins Bank me 3 emetime. Klientët e shikojnë këtë produkt të Credins Bank si një alternativë shumë të mirë investimi.

DEPOZITAT SIPAS SEGMENTEVE



■ Individe
■ Korporate
■ Sme
■ Mikro dhe Agro
■ Institucione Publike
■ Organizata jo Qeveritare

Përveç kujdestarisë për letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare, pjesë të konsiderueshme ka marrë edhe kujdestaria për obligacionet e emetuara nga shoqëritë aksionare, si dhe transaksionet e transferimit të këtyre titujve. Departamenti i Thesarit edhe pse ka realizuar me sukses detyrat gjatë vitit 2017, duke rezultuar në rritje të fitimeve dhe ulje të kostove në produkte, duke ofruar qëndrueshmëri dhe rritje të bashkëpunimit me bankat rezidente, vazhdon të jetë në kërkim të metodave dhe zgjidhjeve më efektive në menaxhimin e Likuiditetit.


Menaxhimi efektiv i likuiditetit, fleksibiliteti, kosto e ulët, shpejtësia në veprime, tregtimi 24 orë i monedhave dhe transparenca janë ndër vetitë dominuese të Departamentit të Thesarit, të cilat edhe për vitin 2017 çuan në rritjen e fitimeve jo vetëm për Credins Bank por edhe për Klientët. Ndjekja e ecurisë së tregjeve financiare nga një staf i kualifikuar dhe ofrimi i mundësive më të mira klientëve në lidhje me investimet, kanë qenë dhe mbeten një sfidë e vazhdueshme për Departamentin e Thesarit. Një ndër objektivat e Departamentit të Thesarit është ofrimi i investimeve alternative në tregjet financiare për klientët e Bankës, sidomos gjatë kësaj periudhe që përfitimet nga interesat e depozitave kanë qëndruar në nivele të ulëta. Të ardhurat nga shitja e Letrave me vlerë dhe të ardhurat nga obligacionet janë rritur nga viti 2016 në 2017 me 20% dhe 39%.

Rritja e volumit të këmbimeve pranë Bankës në masën 25% nga viti 2016 në vitin 2017 është e reflektuar dhe në rritjen e të ardhurave nga këmbimet valutore. Vlera më e lartë e rritjes së të ardhurave nga këmbimi valutor është në tremujorin e parë dhe të dytë të 2017 përkatësisht rritje deri në masën 77%.

DIVIZIONI I RISKUT

Banka Credins i kushton një vëmendje të veçantë procesit të manaxhimit të riskut, jo vetëm si aspekt dhe kërkesë rregullatore, por si frymë e përgjithshme që udhëheq veprimtarinë e përditshme bankare.

HUADHENIA SIPAS MONEDHAVE




Për manaxhimin e riskut banka ka struktura të dedikuara të cilat kryejnë monitorimin e riskut në veprimtarinë e përditshme bankare. Struktura kryesore për manaxhimin e riskut është Divizioni i Administrimit të Riskut, i cili është përgjegjës për të identifikuar, matur, monitoruar, parandaluar dhe raportuar aktivitetin e lidhur me manaxhimin e rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut, rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional dhe rrezikut ligjor. Gjatë vitit 2017, të gjitha strukturat e Riskut si dhe Komitetet e Riskut, Kontrollit, ALCO dhe deri te Këshilli Drejtues kanë siguruar një menaxhim të kujdesshëm në përputhje me kuadrin rregullator dhe legjislationin përkatës përfshirë dhe atë kundër aktiviteteve për pastrimin e parave. Gjatë 2017, Credins bank ka synuar të ketë një balancim mes tërheqjes së fondeve në monedha të ndryshme dhe në investimin e tyre nëpërmjet dhënies së huave në këto monedha. Njëkohësisht për bankën ka qenë e rëndësishme zbutja e ekspozimit ndaj riskut indirekt të kredisë, si pasojë e kursit të këmbimit, edhe duke rekomanduar marrjen e huave nga klientët në monedhë të njëjta me të ardhurat e tyre, ose në raste të tjera në konvertimin e huave ekzistuese në Euro drejt monedhës vendase. Kjo gjë shfaqet në një nivel më të ulët të Credins bank ndaj këtij ekspozimi në raport me të dhënat e publikuara si për kreditë dhe për depozitat që ka gjithë sistemi bankar vendas. Në këto kushte vlerësohen të rëndësishme masat përtej sistemit bankar, në sistemin ekonomik të vendit, ku parësore është pjesa e informalitetit dhe nxitja e përdorimit të monedhës vendase në pjesën

dërmuese të transaksioneve brenda vendit. Fryma e përgjithshme e indeksimit të gati gjithë mallrave të tregtuara me pakicë në monedhën europiane, veçanërisht ato direkte nga importi, drejt një indeksimi vetëm në monedhën vendase, do të japë një ndihmesë të rëndësishme në kërkesën e lartë për euro që ekziston tashmë në tregun shqiptar.

Njëkohësisht masat për informimin e klientelës së bankave rreth risqeve të ekspozimit nga luhatjet e kursit të këmbimit janë një ndihmesë në ndërgjegjësimin dhe udhëzimin drejt një investimi më të sigurt. Kjo masë është ndjekur nga Credins bank si pjesë e informimit dhe transparencës ndaj publikut, duke i parashtruar në formë të detajuar në marrëveshjet me klientët, dhe në mënyrë të ndjeshme drejtpërsëdrejti në dialogun e përditshëm në këshillimin që ofron banka për gjithë klientët e saj.

PROJEKTET

Gjatë vitit 2017 Departamenti i Projekteve u fokusua kryesisht në një analizë të detajuar të realizimit të planit tre vjeçar dhe përgatitjen e strategjisë së re të bankës për tre vjeçarin e ardhshëm. Strategjia e përgatitur nga Komiteti i Strategjisë u prezantua në mbledhjen e Këshillit



Drejtues dhe mori aprovimin e tij. Strategjia 2018-2020 : Specializimin dhe forcimin e tradicionales (njësia e kontaktit, shërbimet e specializuara) dhe kanalet online (bankë në shtëpi, tabletë, celular); forcimi i komunikimit me multi-kanale në përputhje me preferencat e klientëve për të rritur nivelin e shërbimit dhe shitjet. Njësi e dedikuar për të përsheptuar shitjet në kanalet online; mbulimi gjithëpërfshirës i klientëve për të krijuar mundësi të reja komerciale me fokus kënaqësinë e konsumatorëve dhe shitjen e kryqëzuar; krijimi i rolit të menaxherit të marrëdhënieve me klientin; ofrimi i zgjidhjeve CRM dhe krijimi i rolit të menaxherit të produkteve. Ndërkohë projekti “Përmirësimi i menaxhimit të proceseve në front office” ashtu siç ishte planifikuar i kombinuar me përmirësime logjistike ka filluar të reflektojë përmirësimin e proceseve në front office, si dhe rritjen e efektivitetit të vetë procesit të shitjes. Në kontekstin e komunikimit me palët e treta Credins bank vazhdon marrëdhëniet me palët e treta (IFC, EBRD, DFE, KFW, BSTDB, ICD, METSZH, AZHBR, MADA) dhe pjesë e detyrimeve kontraktuale në këto marrëdhënie është monitorimi dhe raportimi i aktiviteteve, pjesë e aktivitetit të Departamentit të Projekteve.

RAJONI DURRËS



HUADHËNIA

9.8%
TË PORTOFOLIT
TË BANKËS

DEPOZITA

9.9%
TË PORTOFOLIT
TË BANKËS

28,318

KLIENTË

GOVERNANCA



ELTON TORO
ANËTAR

RAIMONDA DUKA
ANËTARE

MALTIN KORKUTI
ANËTAR

SAJMIR SALLAKU
KRYETAR

JONAS HASSELROT
ANËTAR

MONIKA MILO
ANËTARE

CLIVE MOODY
ZV. KRYETAR



KËSHILLI DREJTUES



STRUKTURA DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANEVE DREJTUESE TË BANKËS CREDINS

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Asambleja e Aksionarëve është organi më i lartë vendim-marrës i Bankës që përfaqësohet dhe përbëhet nga të gjithë aksionarët e Bankës. Vendimet e Asamblesë së Aksionarëve të marra në përputhje me ligjin dhe me Statutin e Bankës janë të detyrueshme për të gjithë aksionarët, këshillin drejtues, drejtorinë dhe punonjësit, apo përfaqësuesit e Bankës. Asambleja e Aksionarëve vendos për çdo çështje nëpërmjet vendimeve të marra me shumicë të thjeshtë ose të cilësuar. Pa cënuar të drejta të tjera që mund të ketë sipas ligjit, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të zakonshme në veçanti për çështjet e mëposhtme:

- a) të miratojë politikat e veprimtarisë bankare e financiare të Bankës dhe kufijtë e operacioneve të shoqërisë;
- b) të miratojë pasqyrat financiare, raportet e ecursisë së veprimtarisë dhe buxhetin;
- c) të shkarkojë Këshillin Drejtues dhe /ose Drejtorinë nga detyrimi financiar që buron për shkak të ushtrimit të funksioneve të drejtimit dhe administrimit të shoqërisë, në raste të veçanta.
- d) të emërojë ekspertin kontabël të autorizuar dhe skemën e shpërblimit të tij;
- e) të miratojë marrëveshje me të tretët për administrimin dhe drejtimin e shoqërisë.
- f) të miratojë shitjen e aktiveve të Bankës me vlerë kontabël mbi 1,000,000 (një milion) EUR;
- g) të përcaktojë shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues, pagën dhe shpërblimet e anëtarëve të Drejtorisë dhe shpërblimin e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit si dhe shpërblimin e anëtarëve të çdo komiteti tjetër të Këshillit Drejtues; emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe anëtarëve të tjerë të Drejtorisë, përveç Drejtorit të Përgjithshëm; dhe

h) të zgjedhë zëvendës Kryetarin e Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar për çështjet e mëposhtme:

- a) të ndryshojë Statutin e Bankës.
- b) të miratojë marrjen përsipër të mjeteve, detyrimeve apo borxheve financiare të shoqërisë, mbi një vlerë të caktuar që do të përcaktohet nga Këshilli Drejtues.
- c) të emërojë dhe shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm;
- d) të miratojë blerjet e pasurive të paluajtshme mbi shumën 1.000.000 (një milion) Euro, përveçse në rastet kur këto blerje kryhen në lidhje me ekzekutimin apo marrjen në pronësi të kolateralit që është dhënë në favor të Bankës, në rastet e mospagimit në kohë të detyrimeve të siguruara, me kusht që edhe nëse ndodh kjo e fundit Asambleja e Përgjithshme do të informohet paraprakisht për këto blerje;
- e) të miratojë prishjen, riorganizimin, bashkimin, ndarjen, e Bankës;
- f) të miratojë krijimin e filialeve dhe të degëve të Bankës jashtë Shqipërisë.
- g) zvogëlimin ose zmadhimin e kapitalit të Bankës;
- h) të miratojë shpërndarjen e fitimeve në bazë të pasqyrave vjetore dhe raportit të mirëadministrimit të Bankës;
- i) miraton rregullat për procedurat e mbajtjes dhe pjesëmarrjen në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- j) të miratojë emetimin e obligacioneve afatgjata (borxh i varur).
- k) të miratojë marrëveshjet për marrjen nga Banka të huave (borxh i varur). Si dhe për çështje të tjera përveç sa më sipër, që duhen vendosur me shumicë të cilësuar.

KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues është përgjegjës kundrejt aksionarëve për krijimin dhe sigurimin e vlerave të qëndrueshme për ta nëpërmjet administrimit të aktiviteteve të Bankës. Për rrjedhojë ai përcakton objektivat dhe politikat strategjike të Bankës për të siguruar këto vlera afatgjata, ofron drejtim të përgjithshëm strategjik në kuadër të shpërblimeve, stimuljeve dhe kontrolleve. Këshilli duhet të sigurojë që drejtoria të vendosë një ekuilibër të përshtatshëm midis promovimit të zhvillimit afatgjatë dhe arritjes së objektivave afatshkurtër.

Këshilli Drejtues është organ vendim-marrës dhe mbikëqyrës, përgjegjës ndër të tjera për:

- a)** miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe strategjive të Bankës në lidhje me plan - biznesin, me administrimin e rrezikut, me buxhetin vjetor;
- b)** përcaktimin e objektivave afatgjata të Bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave;
- c)** monitorimin e efektivitetit të praktikave të drejtimit të Bankës dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e këtyre praktikave;
- d)** krijimin e komiteteve në rastet kur është e nevojshme, për trajtimin e çështjeve që paraqesin interes të veçantë për Bankën, duke përcaktuar qartë kohëzgjatjen e mandatit, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës;
- e)** përcaktimin e kushteve dhe standardeve për përzgjedhjen, shpërblimin, pagën, vlerësimin dhe largimin e drejtorëve të Bankës, si dhe monitorimin e praktikave për zëvendësimin e personelit të Bankës;
- f)** monitorimin dhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të aksionerëve, përfshirë këtu edhe trajtimin

e konflikteve të mundshme të interesit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të Bankës dhe veprimet me personat e lidhur;

g) marrjen e masave të nevojshme dhe të mjaftueshme për të siguruar integritetin e sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të Bankës, duke përfshirë kontrollin e pavarur të Bankës dhe duke siguruar ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të kontrollit, veçanërisht në lidhje me administrimin e rrezikut, sistemin operacional dhe financiar të Bankës, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe praktikave më të mira në fushën bankare;

h) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore e rregullative dhe të praktikave më të mira në sistemin bankar;

i) mbikëqyrjen e procesit të dhënies së informacionit dhe komunikimin me publikun.

j) përcaktimin e rregullave të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;

k) miratimin e rregulloreve për organizimin e brendshëm të Bankës;

l) miratimin e blerjes së aseteve me vlerë kumulative mbi 500,000 Euro nga huamarrësit e Bankës në rastet kur këto asete janë vënë në shitje në kuadër të një procedure ekzekutimi.

m) miratimin e shitjes së aseteve të Bankës me vlerë kontabël mbi 500,000 Euro. Këshilli Drejtues ka krijuar dy komitete të specializuara në nivel këshilli drejtues, si komiteti i riskut dhe komiteti i emërimeve dhe shpërblimeve, të cilat këshillojnë/asistojnë këshillin për çështje të veçanta. Komiteti i Riskut ka përgjegjësinë e përgjithshme të rishikojë dhe këshillojë Këshillin për profilin aktual të rrezikut të Bankës dhe strategjinë e saj të ardhshme të rrezikut. Ai përbëhet nga tre anëtarë, dy janë drejtorë jo-ekzekutiv dhe njëri drejtor ekzekutiv. Kryetari është drejtor i pavarur dhe raporton në mbledhjen e radhës së Këshillit

Drejtues për çështje të diskutuara dhe të ngritura në mbledhjen e Komitetit. Komiteti i Emërimeve dhe Shpërblimeve ka si qëllim të mbikqyrë emërimet dhe sistemin e shpërblimeve si dhe të rishikojë, vlerësojë dhe rekomandojë Këshillin Drejtues mbi aprovimin e politikave të emërimeve, trainimeve, rekrutimeve dhe shpërblimeve. Ky Komitet rishikon në emër të Këshillit, kandidatët për anëtarë të Këshillit Drejtues apo anëtarë të Komiteteve të tjera, drejtues ekzekutiv apo manaxher të lartë të Bankës. Ai përbëhet nga tre anëtarë, të cilët janë drejtorë jo ekzekutiv.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Drejtoria përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe dy Zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga detyra me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Drejtori i Përgjithshëm është dhe Kryetar i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve dhe është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e përditshëm të Bankës.

Drejtoria është përgjegjëse për mbajtjen e kontabilitetit të bankës në mënyrën e duhur dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me ligjin, për paraqitjen e një raporti pranë Këshillit Drejtues të paktën një herë në tre muaj dhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore të paktën brenda tre muajve pas datës së mbylljes së vitit financiar.

Secili anëtar i Drejtorisë, në zgjedhjen dhe emërimin e tij, pavarësisht nëse merr pjesë në ndonjë vendimmarrje, duhet t'i deklarojë fillimisht me shkrim Këshillit Drejtues, të gjitha interesat e tij personale siç parashikohet në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Drejtori i Përgjithshëm perfaqëson ligjërisht bankën. Këshilli Drejtues për çështje të veçanta mund të autorizojë përfaqësimin e Bankës nga dy anëtarë të Drejtorisë së bashku.

Drejtori i Përgjithshëm detyrohet të informojë Këshillin Drejtues për administrimin që ai i bën Bankës. Këshilli Drejtues përcakton me akt të veçantë detyrimet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe procedurat për informimin e Këshillit Drejtues. Drejtori i Përgjithshëm në mënyrë të veçantë detyrohet si më poshtë:

a) të paraqesë në Këshillin Drejtues pasqyrat financiare periodike;

b) të propozojë buxhetin vjetor në Këshillin Drejtues;

c) të propozojë planin e biznesit në Këshillin Drejtues;

d) të informojë Këshillin Drejtues për çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore që prekin veprimtarinë e bankës;

e) të informojë periodikisht por jo më pak se një herë në muaj Këshillin Drejtues për marrëdhëniet e bankës me Bankën e Shqipërisë dhe organet e tjera publike që lidhen me veprimtarinë e bankës; dhe/ose **f)** të informojë Këshillin Drejtues për çdo fakt ose ngjarje që prek ose mund të prekë veprimtarinë e bankës.

KOMITETI I KONTROLLIT

Banka kontrollohet nga Komiteti i Kontrollit. Komiteti i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë, që emërohen nga Asambleja e Aksionareve dhe ka këto detyra:

a) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;

b) shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;

c) propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të Bankës;

d) bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;

e) kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së Bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet Këshillin Drejtues të bankës;

f) i jep mendim Këshillit Drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkojnë prej këtij të fundit;

g) miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

KONTEKSTI RREGULLATOR

Gjatë vitit 2017, pati ndryshime të shumta rregullatore të cilat impaktuan sektorë të ndryshëm të bankës dhe u reflektuan në modifikime në rregullatore e procedura të brendshme. Totali i ndryshimeve i kalon 108 me një ndarje si më poshtë:

Departamenti Financës	23
Departamenti Juridik	32
Departamenti Burimeve Njerëzore	7
Drejtoria e Sigurisë	6
Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit	7
Kredia dhe Risku	18
Të tjera	15

RAJONI JUG



HUADHËNIA

11.8%
TË PORTOFOLIT
TË BANKËS

DEPOZITA

29.7%
TË PORTOFOLIT
TË BANKËS


64,920

KLIENTË

BURIMET NJERËZORE

IV

REKRUTIMI DHE PROMOVIMI




Gjatë vitit 2017 nga Sektori i Trajnimeve janë intervistuar 1027 kandidatura për pozicione të ndryshme nga të cilët janë rekrutuar 123 punonjës të rinj kryesisht studentë të ekselencës dhe punonjës me eksperiencë bankare. Edhe gjatë vitit 2017, Credins Bank nuk ka munguar në Panairët e Punës dhe të Studimit të organizuara nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Bashkia Tiranë, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë si dhe nga 6 Institucione të arsimit të lartë në vend.

Strategjia e Departamentit të Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2017 ishte fokusuar tërësisht në transformimin e Credins Bank në punëdhënësin më të mirë në vend, duke i mundur çdo punonjësi rritje profesionale dhe në karrierë ku vetëm gjatë vitit 2017 janë promovuar në pozicione të reja 76 punonjës.

TRAJNIME DHE ZHVILLIME



Edhe gjatë vitit 2017 kemi besuar në skuadrën tonë dhe kompaninë e ndërtuar deri me tani duke rritur investimet për zhvillimin dhe trajnimin e asetit më të rëndësishëm të Bankës, të cilët na mundësojnë të diferencohemi nga bankat e tjera me një shërbim më të mirë dhe standarte të njejta ndaj klientëve tanë.

Për herë të parë gjatë vitit 2017 nga Sektori i Trajnimeve është lancuar Kalendar i Trajnimeve. Ky kalendar ka ofruar 18 programe trajnimi bazë dhe zhvilluese me qëllim rritjen e aftësive personale dhe profesionale të stafit. Këto trajnime janë përqëndruar në zhvillimin e aftësive të komunikimit, prezantimit efektiv, punës në grup, zgjidhjes së problemeve, menaxhimit e



konflikteve, gjuhës angleze, kurseve të excelit, etj. Programet për stafin Drejtues janë organizuar kryesisht në fushën e Menaxhimit dhe Drejtimit, Përmirësimi i Proceseve të Biznesit, Drejtimi nëpërmjet Inteligjencës Emocionale, Planifikimi Strategjik i avancuar, programe të cilat kanë synuar zhvillimin e standardit të skuadrës manaxhuese për një drejtim të suksesshëm dhe vizionar të Bankës.

Në kuadër të shtrirjes së projektit SFE në të gjithë Rrjetin e Degëve është intensifikuar puna dhe investimi në trajnime për implementimin dhe rritjen e standarteve të shitjes dhe të shërbimit të klientelës nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve për stafin e Degëve me gjashtë modulet e Menaxhimit të Shitjeve.



RAJONI VERI



HUADHËNIA

6.8%
TË PORTOFOLIT
TË BANKËS

DEPOZITA

12.8%
TË PORTOFOLIT
TË BANKËS

30,884

KLIENTË

PERGJEGJESIA SOCIALE

V

PËRGJEGJËSIA SOCIALE NË CREDINS BANK

Credins Bank, si institucioni bankar i tretë më i madh në vend, është i lidhur ngushtë me ekonominë dhe shoqërinë, duke ndërë përgjegjësi ndaj komunitetit tek i cili operon prej plot 15 vitesh.

Për Credins Bank, përgjegjësia e sociale, ka të bëjë me krijimin e një vlere të qëndrueshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe palët e tjera të interesit. Prioriteti ynë i parë është që të veprojmë si një partner financiar i besueshëm për klientët tanë, duke ofruar shërbime dhe këshilla për të përbushur nevojat e tyre individuale. Ne, synojmë t'i përmbahemi vlerave etike dhe standardeve profesionale të përcaktuara në Kodin e Sjelljes në çdo aspekt të punës sonë.

Prej dy vitesh, Credins Bank i është bashkëlidhur iniciativës së Shoqatës Shqiptare të Bankave për të prezantuar sëbashku me Përgjegjësinë Sociale dhe kontributin që jep në përbushjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG) të Kombeve të Bashkuara. Gjatë vitit 2017, iniciativat tona, kanë kontribuar kryesisht në përbushjen e objektivave: 2 (Zero Uri), 3 (Shëndet i mirë dhe Mirëqënie), 4 (Arsim Cilësor), 8 (Punë Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike), 9 (Industri, Novacion Dhe Infrastrukturë), 11 (Qytete Dhe Komunitete Të Qëndrueshme) dhe 17 (Partneriteti Global).

Duke aplikuar ekspertizën tonë në transaksionet e tregut të kapitalit, adresojmë Objektivat: 9 (Industri, Novacion dhe Infrastrukturë) dhe 11 (Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme) Duke operuar në një industri e cila po zhvillohet dhe rritet me hapa të shpejta, ne, sigurohemi që



edhe punonjësit tanë vazhdimisht të zhvillojnë aftësitë dhe ekspertizën e tyre për të mbështetur dhe shërbyer akoma më mirë klientëve tanë. Përmes ndryshueshmërisë së forcës sonë shitëse, njohurive dhe përvojës së punonjësve tanë, ne gjithashtu adresojmë objektivat: 4 (Arsim Cilësor), 5 (Barazi Gjinore) dhe 8 (Rritje e Qëndrueshme Ekonomike dhe Punësim).

Besojmë, se qasja në biznes në mënyrë të përgjegjshme, është faktori kryesor që përcakton suksesin tonë afatgjatë dhe ndihmon të promovojë rolin e rëndësishëm që ne luajmë në ekonominë e vendit dhe në shoqëri.

Aktivitetet e ndërmarra dhe mbështetura nga Credins Bank, në kuadër të Përgjegjësisë Sociale në përputhje me 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm vitin 2017.

OBJEKTIVI 2: ZERO URI

Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme!

Credins Bank i kushton një vëmendje të veçantë kontributit në mbështetje të eliminimit të urisë në çdo lloj forme. Gjatë vitit 2017 Banka ka bashkëpunuar me organizata dhe projekte të ndryshme që ndihmojnë në eliminimin e varfërisë për shtresat në nevojë dhe për fëmijet pa përkujdesje prindërore. Credins Bank është një institucion gjithmonë në mbështetje të promovimit të një jetese të mirë dhe ka një rol kyç në sensibilizimin e popullsisë për një mirëqenie dhe jetesë të shëndetshme.

■ Në mbështetje të këtij objekti, edhe gjatë 2017, Credins vazhdoi të mbulojë shpenzimet për 3 fëmijë në fshatin SOS duke nxitur fuqizimin e mëtejshëm të: “SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiptarë”, për t’i dhënë akoma më shumë mundësi fëmijëve në Shqipëri dhe investuar në një shtëpi të lumtur.

■ Degët e Credins Bank në qytetin e Fierit në mënyrë vullnetare janë organizuar duke dhuruar veshje dhe ushqime për Kryqin e Kuq Shqiptar, shoqata më e vjetër humanitare në Shqipëri.

Kontributi gjatë Vitit: 1,300.000 Lekë

OBJEKTIVI 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe!

Credins Bank është një nga mbështetësit më aktiv në komunitet, në nismat për shëndet dhe mirëqenie, iniciativa të cilat kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, promovimin e shëndetit dhe sensibilizimin e popullsisë për mirëqenie e shëndet më të mirë.

■ Credins Bank mbështeti Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në aktivitetet e ndërmarra në kuadër të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit gjatë muajit Tetor. Nën thirrjen: “Eja edhe ti në Markatën Rozë” banka u bë pjesë e një sërë aktiviteteve për rritjen e informimit dhe depistimit në të gjithë vendin, ndër të cilat: shitja e buqetave me lule pranë Pazarit të Ri, në 15 Tetor, te Sheshi Kreativ në Tiranë. Aktivitet ky, i cili kishte si qëllim mbledhjen e fondeve dhe investimin e tyre në blerjen e pajisjes për diagnostikimin e kancerit të gjirit duke mundësuar parandalimin e saj në kohë.

■ Të gjithë klientët Credins, duke përvetësuar një nga produktet apo shërbimet bankare me të cilat banka operon, përfiton Sigurimin e Jetës dhe Aksidenteve Falas në rrjetin e klinikave SiCRED. Kjo iniciativë, gjatë vitit 2017, përfshiu dy segmente të reja: Studentët dhe Pensionistët.

■ Credins Bank bashkëpunon me “Fondacionin e Fëmijëve Shqiptarë” duke ofruar mbështetje financiare për qendren për zhvillimin e fëmijëve me probleme autike.

Kontributi gjatë Vitit: 886,286 Lekë



MONIKA MILO
ZV.DREJTORE E PËRGJITHSHME, CREDINS BANK

OBJEKTIVI #5

Krenare që në kontekstin global për fuqizimin e rolit të gruas, Credins Bank e pozicionon veten si një kontribues aktiv në përmbushjen e

Objektivit #5

Për një zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (sdg) - arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Gratë po ndryshojnë profilin global të ekonomisë, duke krijuar rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm. Mendohet që 30% e bizneseve të rregjistruara në botë, janë me pronare gra. Sipas një studimi të Harvard Business Review, gratë kontrollojnë 20 trilion të shpenzimeve globale të konsumatorëve. Sot, Credins punëson 636 gra dhe vajza në të gjithë vendin, nga të cilat 112 janë në pozicione drejtuese, duke përfshirë drejtues ekzekutivë dhe anëtarë bordi.”

OJEKTIVI 4: ARSIM CILËSOR

Sigurimi i arsimit përfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxënësve gjatë gjithë jetës.

Credins Bank beson se arsimi, arti, kultura dhe informimi i gjerë, janë një nga kontributet më të çmuara në dobi të komunitetit dhe zhvillimit të vazhdueshëm. Rritja dhe përfshirja e numrit të të rinjve dhe të rriturve me aftësi teknike dhe profesionale për punësim, punë të denja dhe sipërmarrje është thelbësore në ndërtimin e një shoqërie dhe komuniteti më të fortë dhe qëndrueshëm. Në kuadër të politikave të përgjegjësisë sociale, ky kontribut është reflektuar përmes mbështetjen financiare të një sërë aktiviteteve të tilla si:

- Mbulimi i shpenzimeve për botimin e disa librave nga autorë shqiptarë, si: “Loja që ndryshoi Shqipërinë” dhe “Bukuritë Shqiptare”.

- Mbështetje për konkursin “Sipërmarrësit e së Nesërme” të organizuar nga Tirana Business University si dhe aktiviteti “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement Albania.

- Kontribut në edukimin financiar të qytetarëve e sidomos të rinjve. Credins Bank, financoi shpërndarjen e 3 çmimeve të para për konkursin “Video më e mirë”, aktivitet i organizuar në kuadër të Javës së Parasë 2017, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave - AAB (Albanian Bank Association) dhe Bankën e Shqipërisë.

- Organizuam një takim miqësor me nxënësit e shkollës Qemal Stafa, në zyrat qendrore të Credins Bank në kuadër të Javës Së Parasë 2017. Vizita e nxënësve u konceptua në tre etapa; një prezantim i shkurtër për t’i shpjeguar si të kujdesen për paratë, si të kursejnë, si të mendojnë financiarisht apo dhe si t’i kuptojnë ndryshimet në sistemet ekonomike.



Foto nga fushata promociionale # Credins për Studentët

- Mbështetje për shkollën e mesme “Bilal Golemi” Ura e Kardhiqit, Gjirokastrë në mbulimin e shpenzimeve për aktivitetin me biçikleta për 40 nxënës të kësaj shkolle në kuadër të edukimit formal dhe programit mësimor të shkollës.

- Bashkëpunim me Junior Achievement për programin e mentorimit në shkolla si dhe për aktivitetin “Leader Për Një Ditë” që edukon dhe angazhon të rinj në të gjithë vendin me praktikën e sipërmarrjes.

Në Credins Bank ne besojmë se studentët kanë shumë sfida. Dhe në morinë e sfidave të tyre, ne ju propozojmë partneritetin tonë për të lehtësuar pagesat, mirëmenaxhuar kohën dhe për të siguruar avantazhe konkurruese me aksesin në financë. Gjatë 2017, zgjodhëm të shkonim në një tur në Universitetet Shqiptare Publike dhe Jopublike, në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë për të mësuar më shumë rreth sfidave studentore dhe për të propozuar zgjidhjet tona financiare.

Kontributi gjatë Vitit: 3,004,000 Lekë

OBJEKTIVI 8: PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE

Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë e produktiv dhe punë së denjë për të gjithë.

Pjesë e politikave mbështetëse të Credins Bank është përkujdesja që tregohet në lidhje me përmirësimin e shërbimeve që ofrohen në institucionet shtetërore, duke mbështetur investimet që po realizohen në favor të përmirësimit të shërbimit publik. Gjithashtu, realizimi i punësimit produktiv, promovimi, zhvillimi i punonjësve dhe realizimi i punës së denjë për të gjithë, mbetet objekti i pandryshuar prej vitesh.

■ Në mbështetje të forcimit të kapacitetit të institucioneve financiare Credins bashkëpunoi me AK Invest dhe Postën Shqiptare duke ndërtuar një infrastrukturë më të favorshme, e cila ofron akses dhe lehtësi në shërbimet bankare për të gjithë qytetarët e klientët, edhe në zonat në të cilat banka nuk është prezente. Në këto skema, kostot për përdorimin e shërbimit nga klienti mbulohen nga Banka.

■ Në kuadër të zgjerimit të aksesit në shërbime bankare dhe të qenit akoma më pranë klientëve, Credins ka rikonstruktuar dhe rivitalizuar një pjesë të degëve ekzistuese të bankës. Akoma më tej, është rritur numri i degëve të reja dhe numri i makinave të automatizuara për tërheqje parash (ATM) në të gjithë Shqipërinë. Numri i degëve dhe ATM të Credins Bank në të gjithë vendin është aktualisht 58 Degë dhe 68 ATM. Numri i transaksioneve në ATM, përgjatë 2017 ka kapur shifrën 1,590,054 Transaksione.

■ Gjatë 2017, banka ka bashkëpunuar me programet e Qeverisë dhe të Bashkisë së Tiranës për nxitjen e punësimit të të rinjve dhe dhënien e shanseve të barabarta për të gjithë, duke ofruar mundësi praktikash pune për 17 persona nga të cilet 10 janë punësuar në Credins.

Kontributi gjatë Vitit: 5,600,841 Lekë

OBJEKTIVI 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË

Ndërtimi i një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit përfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.

Credins Bank, ka investuar dhe zhvilluar politika për mbështetjen me financim të projekteve në përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve jetësore. Gjatë 2017, banka ka kontribuar për institucionet publike dhe jopublike, duke investuar në zhvillimin e një infrastrukture cilësore, e duke i bërë këto institucione të besueshme, të qëndrueshme dhe efikase në shfrytëzimin e burimeve dhe përdorim më të madh të teknologjive. Mbështetje e cila ka sjellë në mënyrë paralele nxitjen e mirëqënies njerëzore.

■ Mbështetje financiare për iniciativat e ndërmarra në përmirësimin e kushteve fizike (rikonstruksion dhe restaurim ambjentesh të jashtme dhe të brendshme) për institucione të sistemit shëndetësor dhe institucione të tjera të administratës publike. Të tilla si: Spitali Rajonal Shkodër, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, Qendra Spitalore Universitare Tiranë, Drejtoria Rajonale e Aluiznit Sarandë, Reparti Ushtarak Nr.4001, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Qendra Shëndetësore Nr.9 dhe Drejtoria Arsimore Kukës.

■ Në vijim të Politikave të Përgjegjësisë Sociale, në përkujdesje të vazhdueshme për mirëqënie, progresit dhe zhvillimit të mjedisit ku ushtron aktivitetin e saj, Credins Bank ka ndërmarrë nismën e mbështetjes me pajisje fizike si: aparatura, ngrohëse dhe pajisje zyre, për institucionet: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano” dhe Qendra Shëndetësore Nr.2 Berat.

Kontributi gjatë Vitit: 9,457,529 Lekë

OBJEKTIVI 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurta, të forta dhe të qëndrueshme!

Credins Bank është një aktor i rëndësishëm në ndërtimin e një komuniteti aktiv dhe qyteteve me zhvillim të qëndrueshëm, duke investuar në aktivitete kulturore dhe promovuese të artit në të gjithë vendin. Nëpërmjet financimit të këtyre iniciativave, banka synon të forcojë dhe nxisi përpjekjet për të mbrojtur dhe garantuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore të botës. Një tjetër aspekt i këtij kontributit gjatë 2017, ishte ofrimi i aksesit në hapësira publike të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të gjelbërta. Bërja e qyteteve dhe komunitetit të qëndrueshëm kërkon mbështetje edhe për ato vende të cilat janë më pak të zhvilluara, në këtë kuadër, banka ka ndihmuar financiarisht dhe teknikisht për ndërtimin e ndërtesave dhe institucioneve të qëndrueshme dhe elastike.

■ Credins Bank ishte një nga përkrahësit dhe mbështetësit kryesorë që bënë të mundur ardhjen në Shqipëri dhe ekspozimit në Galerinë Kombëtare të Arteve, të koleksionit të Kryeveprave të Artit Italian të viteve 1900 të galerisë së Artit Modern të Romës, “Novecento”. Gjithashtu, banka pati edhe një bashkëpunim me Shoqatën Kulturore VIZart në botimin e katalogëve për aktivitetin kulturor “2nd Tirana International Watercolor Biennale 2017”.

■ Mbështeti financiarisht: Qendrën Kulturore për fëmijë, Teatri i Kukullave në realizimin e klipit “Shqipëria Imë”, Shoqatën Eja në Teatër në vënien në skenë të shfaqes “Shirlin Valentina” si dhe Ministrinë e Kulturës në aktivitetin Biennale 2017.

■ Sponsorizoi, Federatën Aeronautike Shqiptare në aktivitetin sportiv “Paragliding 2017” si dhe Federatën Shqiptare të Snookerit në organizimin e Kampionatit European të Snookerit 2017.

■ Mbështetje financiare për bërjen e institucioneve më të “forta” dhe bashkëkohore. Credins, mbuloi shpenzimet për pajisjen me kondicionerë të Spitalit Rajonal Shkodër, duke përmirësuar kushtet fizike të këtij institucioni si dhe Qendrën Shëndetësore Nr.1, Iranian në Tiranë duke mbuluar shpenzimet për vendosjen e stendave për biçikleta pranë kësaj qendre.

■ Në kuadër të përkujdesjes ndaj ambjentit dhe komunitetit, Credins Bank u bë pjesë e zbatimit të projektit “Pylli Orbital”, iniciativë e Bashkisë Tiranë. Credins, mbolli 110 Pemë në zonën në zonën e liqenit të thatë, duke rritur ndërgjegjësimin e komunitetit për ambjentin, promovimin dhe shtimin e zonës së gjelbër në Tiranë. Gjithashtu, banka, mbështeti Bashkinë Shkodër, duke financuar zbulimin e qytetit për festat e fundvitit.

■ Sponsorizoi eventet dhe aktivitete e ndërmarra brenda dhe jashtë vendit, me rastin e festive kombëtare të 28 dhe 29 Nëntorit përmes institucioneve: Ambasada e Republikës së Shqipërisë, Shkup; Shoqata për zhvillimin e Kulturës dhe Artit “Kongresi i Alfabetit”, Manastir dhe Shoqata Kulturore Artistike, Iliria.

Kontributi gjatë Vitit: 6,933,350 Lekë

OBJEKTIVI 17: PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm.

■ Mbështeti Dhomën Britanike të Tregëtisë dhe Industrisë në Shqipëri në organizimin e konferencës për Promovimin e Zhvillimit të Agrobiznesit në Shqipëri. Një konferencë në funksion të edukimit të gjerë në lidhje me potencialin e Agrobiznesit në Shqipëri dhe gjithashtu në nxitjen e investimit dhe sipërmarrjes në këtë fushë të të bërit biznes.

■ Mbështetiti Konkursin Kombëtar: “Ide të Gjelbra” nga Partners Albania, i cili nxit sipërmarrjen, bizneset sociale prodhimin vendas dhe punësimin. Projekti fitues, i zgjedhur nga banka ishte Aroma Terapi – një sipërmarrje e re që inkurajon prodhimin e produktit vendas përmes përpunimit të vajërave esencial.

■ Gjatë 2017, Credins Bank, ka bashkëpunuar me institucione vendase, si: Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) duke e bërë ofruar lehtësi për shërbimin e pensione dhe solidaritet përmes një pakete shërbimesh dhe produktesh pa komision në kuadër të mbështetjes dhe përkujdesjes së kësaj kategorie të shoqërisë. Gjithashtu, për të gjithë nxënësit dhe studentët që përfitojnë bursa nga Bashkitë e qyteteve, Credins ofron llogari dhe kreditim fondesh pa komision.

■ Në mbështetje të teknojgjësisë, dixhitalizimit dhe bërjes së proçeseve të automatizuara dhe të arritshme për të gjithë qytetarët, Credins bashkëpunoi me Agjencinë Kombëtare të Shërbimeve Informatike për vënien në jetë të platformës e-Albania duke lehtësuar integrimin e pagesave përmes e-Albania në platformat e institucioneve publike përfshirë këtu: Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rugor (DPSHTRR), Policinë e Shtetit dhe atë Bashkiake, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), etj.

Kontributi gjatë Vitit: 1,110,949 Lekë

KULTURË, ART DHE SPORT

■ Credins Bank sponsorizoi TI Institute dhe Muzeun Historik në eventin “Muzeu i Stilit Etno Vibe”, i pari aktivitet në llojin e tij, ku promovohet Moda Bashkëkohore nga Tradita, në ditën e Trashëgimisë Kulturore Shqiptare, 29 Shtator. Banka promovoi këtë iniciativë e cila kontribuon integrimin e etnografisë shqiptare dhe identitetit shqiptar te brezat e rinj dhe te dimensionet moderne.

■ Mbështeti Federatën Shqiptare të Basketbollit.

Gjatë muajit Korrik, FSHB ka prezantuar ekipet eliminatorë për Kampionatin European. Credins Bank, për të disatin vit rradhazi mbështet këtë iniciativë të rëndësishme e cila promovon sportin dhe nxit zhvillimin e tij në vend. Mbështetja vazhdon edhe më gjerë duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në Eliminatore të Botërorit 2019 të Basketbollit për meshkuj. Një tjetër mbështetje në fushën e sportit vjen nga Credins Bank edhe për Klubin Shumësportësh Tiranë, për të cilën banka ka financuar në mbulimin e shpenzimeve për rikonstrukcionin e saj.

■ Credins Bank mbështeti Universitetin e Arteve duke sponsorizuar aktivitetin kushtuar 100 Vjetorit të lindjes së kompozitorit tonë të madh Prenkë Jakova. Teatri i Operas e Baletit ka shpallur 2017-ën, vitin e kompozitorit Prenk Jakova, pasi ky vit, përkon me 100-vjetorin e lindjes së Artistit të Popullit. Credins është partner dhe bashkëpunëtor në iniciativa të tilla të cilat promovojnë artin Shqiptar.

■ “Ruga Drejt Suksesit” Vepra nga Butrint Morina i shtohet koleksionit të veprave të artit në qytetin e Lezhës. Skulptura vjen si rezultat i konkursit “Një Bankë Për Artin” organizuar nga Credins Bank në kuadër të politikave të saj për zhvillim e mbështetje ndaj komunitetit dhe artit.

Kontributi gjatë Vitit: 5,090,000 Lekë

KONCEPTUAR PËR TË SJELLË BANKËN NË DORËN TUAJ



Available on the
App Store



Android app on
Google play

RAPORTI I AUDITOREVE

VI

BANKA CREDINS SH.A.

Pasqyrat Financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më

31 dhjetor 2017

(me raportin e audituesit të pavarur)

TABELA E PËRMBAJTJES

Raporti i Audituesit të Pavarur	i-ii
Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes	1
Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar	3
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit	4
Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare	5
1 Informacion i Përgjithshëm	6
2 Politikat Kontabël	6
3 Të ardhura neto nga interesat	30
4 Të ardhura dhe shpenzime nga tarifat dhe komisionet	30
5 Të ardhura dhe shpenzime të tjera	30
6 Shpenzime personeli	31
7 Shpenzime administrative	31
8 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	32
9 Mjete monetare dhe ekuivalente me to	32
10 Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	33
11 Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	33
12 Letrat me vlerë të investimit të mbajtura për tregtim	33
13 Letra me vlerë të vlefshme për shitje	34
14 Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje	36
15 Qira financiare	37
16 Hua dhe paradhënie klientëve	37
17 Prona të riposeduara	40
18 Aktive afatgjata materiale	41
19 Aktive jo-materiale	42
20 Aktive të tjera	42
21 Aktive tatimore të shtyra	42
22 Detyrime ndaj bankave	43
23 Detyrime ndaj klientëve	43
24 Huatë	43
25 Borxh i varur	44
26 Të tjera hua	45
27 Provigjione	45
28 Kapitali aksionar	45
29 Primi i kapitalit	46
30 Rezerva e përgjithshme	46
31 Analizë maturiteti për aktivet dhe detyrimet	47
32 Angazhime dhe detyrimet e kushtëzuara	48
33 Shënime për palët e lidhura	49
34 Ngjarjet pas datës së bilancit	50
35 Administrimi i rrezikut financiar	51

Raporti i Audituesit të Pavarur

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560

Për Aksionerët dhe Bordin Drejtues të Banka Credins Sh.a.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të 'Credins Sh.a' (më tej referuar si "Banka" ose "Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 dhjetor 2017 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Banka Credins Sh.a për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë audituar nga një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar mbi ato pasqyra financiare të konsoliduara më 31 maj 2017.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare të konsoliduara ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Grupi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të konsoliduara përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Kledion Kodra, FCA

Kodra

Grant Thornton sh.p.k.

Tirana, Albania
12 qershor 2018



Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017¹

Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2017 Lek '000	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2016 Lek '000
Të ardhura nga interesat	3	8,747,753
Shpenzime për interesat	3	(1,854,250)
Të ardhura neto nga interesat	3	6,893,503
Të ardhura nga komisionet	4	843,150
Shpenzime për komisionet	4	(117,443)
Të ardhura neto nga komisionet	4	725,707
Shpenzime të tjera	5	(582,541)
Të ardhura të tjera	5	403,281
Fitimi nga kurset e këmbimit		77,815
Të ardhura të tjera bankare		(101,445)
Humbje nga zhvlerësimi i huave, neto	15,16	(2,307,234)
Humbje nga huatë e pambledhshme	15,16	(317,647)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	19	(37,434)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	18	(269,884)
Shpenzime personeli	6	(1,202,104)
Shpenzime të përgjithshme administrative	7	(2,040,634)
		(6,174,937)
Pjesa e humbjes së investimit me pjesmarrje	14	(5,300)
		-
Fitimi para tatimit		1,337,528
Shpenzime tatimi mbi fitimin	8	(340,392)
Tatim fitimi i shtyrë	21	74,604
Fitimi neto i vitit		1,071,740
Për:		
Aksioneret e Mëmës		1,073,240
Interesa jo-kontrollues		(1,500)
		1,071,740

¹ Shënimet 1 deri 35 në faqe 5 deri ne 70 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

**Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017¹**

Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2016
	Lek '000	Lek '000
Fitimi neto i vitit	1,071,740	254,629
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:</i>		
Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje	13 45,110	(98,984)
Efekti i tatim fitimit	(7,995)	14,847
	42,815	(84,137)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse neto për t'u riklasifikuar në fitim ose humbje në periudhat pasardhëse:	37,155	(84,137)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, pas tatim fitimit	37,155	(84,137)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit mbi fitimin	1,110,395	170,492
Për:		
Aksioneret e Mëmës	1,110,395	172,284
Interesa jo-kontrollues	(2,020)	(1,792)
	1,108,375	170,492

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Bordi Drejtues i Banka Credins sh.a më 29 mars 2018 dhe janë nënshkruar në emër të tij nga:

z. Maltin KORKUTI
Drejtore i Përgjithshëm

znj. Valentina PRODANI
Drejtore e Departamentit Financë-Kontabilitet



¹Shënimet 1 deri 35 në faqet 5 deri në 70 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017¹

	Shënime	31 dhjetor 2017 Lek '000	31 dhjetor 2016 Lek '000
Aktivët			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	9	30,964,607	29,040,607
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	10	11,352,440	11,520,723
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	11	194,606	1,535,146
Letra me vlerë të mbajtura për tregtim	12	450,720	-
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	13	29,322,957	21,308,475
Investime në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje	14	15,950	-
Emri i mirë	14	43,371	43,371
Qira financiare	15	1,065,777	945,775
Hua dhe paradhënie për klientët	16	97,283,218	93,473,577
Te drejta tatimore korrente		-	64,441
Prona të riposeduara	17	4,764,175	3,608,181
Aktive afatgjata materiale	18	2,721,640	2,465,056
Aktive afatgjata jomateriale	19	106,138	122,994
Aktive të tjera	20	1,153,445	1,279,087
Të drejta tatimore të shtyra	21	142,809	75,673
Totali i aktiveve		179,581,853	165,483,106
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare	22	6,099,386	2,492,665
Detyrime ndaj klientëve	23	151,053,971	143,805,272
Huatë	24	186,747	199,861
Borxhi i varur	25	6,257,946	5,410,219
Detyrimet tatimore aktuale		209,590	-
Detyrime të tjera	26	576,957	111,109
Provizione	27	6,875	2,275
Totali i detyrimeve		164,391,472	152,021,401
Kapitali			
Kapitali aksionar	28	8,083,240	7,307,701
Primi i aksioneve	29	3,112,906	2,892,166
Rezerva e përgjithshme	30	1,646,347	1,446,025
Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë të vlefshme për shitje	13	45,075	7,920
Fitime të pashpërndara		2,293,334	1,798,314
Totali i kapitalit aksionar		15,180,902	13,452,126
Interes jo-kontrollues		9,479	9,579
Totali i kapitalit aksionar		15,190,381	13,461,705
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar		179,581,853	165,483,106

¹Shënimet 1 deri 35 në faqet 5 deri në 70 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017¹

	Kapitali aksionar	Primi i lidhur me aksionin	Rezerva e përgjithshme	Rezerva rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Kapitali total i atribueshëm tek aksionarët e mëmës	Interesi jo kontrollues	Totali i kapitalit aksionar
	Lek '000	Lek '000	Lek '000	Lek '000	Lek '000	Lek '000	Lek '000	Lek '000
Gjendja më 31 dhjetor 2016	6,382,916	2,369,595	1,446,025	92,577	1,606,530	11,897,643	7,318	11,904,961
Fitimi i vitit	-	-	-	-	256,941	256,941	(2,312)	254,629
Shpenzime të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(84,657)	-	(84,657)	520	(84,137)
Totali - të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(84,657)	256,941	172,284	(1,792)	170,492
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë (shënimi 28)	65,157	-	-	-	(65,157)	-	-	-
Emetim i aksioneve të reja	859,628	522,571	-	-	-	1,382,199	-	1,382,199
Interesa jokontrolluese si rrjedhojë e bashkimit	-	-	-	-	-	-	4,053	4,053
Gjendja më 31 dhjetor 2016	7,307,701	2,892,166	1,446,025	7,920	1,798,314	13,452,126	9,579	13,461,705
Fitimi i vitit	-	-	-	-	1,073,240	1,073,240	(1,500)	1,071,740
Shpenzime të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	37,155	-	37,155	(520)	36,635
Totali - të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	37,155	1,073,240	1,110,395	(2,020)	1,108,375
Përvetësimi i fitimit të pashpërndarë (shënimi 29)	377,898	-	200,322	-	(578,220)	-	-	-
Emetimi aksioneve të reja	397,641	220,740	-	-	-	618,381	-	618,381
Interesa jokontrolluese si rrjedhojë e bashkimit	-	-	-	-	-	-	1,920	1,920
Gjendja më 31 dhjetor 2017	8,083,240	3,112,906	1,646,347	45,075	2,293,334	15,180,902	9,479	15,190,381

Shënimet 1 deri 35 në faqet 5 deri në 70 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017¹

	Shënime	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2017 Lek '000	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2016 Lek '000
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		1,337,528	416,416
<i>Rregullimet për:</i>			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	18,19	307,318	233,982
Aktivitet afatgjatë të nxjerra jashtë përdorimi	18	162,298	18,802
Zhvlerësimi i huave ndaj klientëve	15,16	2,307,234	3,080,226
Humbje të tjera nga huatë e pambledhshme	15,16	(317,647)	1,060,129
Pjesa e humbjes të investimit me pjesëmarrje		5,300	-
Zhvlerësimi i pronave të riposeduara	17	497,356	52,000
Të ardhurat neto nga interesat	3	(6,893,503)	(7,039,166)
Efekti i kursit të këmbimit në borxhin e varur		-	(274,659)
Flukset e mjeteve monetare të përdorura në aktivitetet operative përpara ndryshimeve në kapitalin e punues		(2,594,116)	(2,452,270)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie bankave	11	1,337,948	248,742
Ndryshimi në hua dhe paradhënie klientëve	16	(5,682,474)	(12,341,421)
Ndryshimi në qiranë financiare	15	(120,002)	19,466
Ndryshimi në shumat e kushtëzuara me Bankën e Shqipërisë	10	168,211	(461,480)
Ndryshimi në pronat e riposeduara	17	(1,653,350)	39,700
Ndryshimi në aktive të tjera	20	191,220	(76,704)
Ndryshimi në detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	22	3,608,221	737,276
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve	23	7,276,170	20,098,315
Ndryshimi në detyrime të tjera	26,27	470,055	4,597
Interesi i arkëtuar		8,569,061	9,364,532
Interesi i paguar		(1,827,053)	(1,976,054)
Tatim fitimi i paguar		(130,802)	(101,299)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		9,613,089	13,103,400
Aktivitetet investuese			
Blerje e letrave me vlerë	12,13	(20,514,205)	(18,687,077)
Shitje e letrave me vlerë	12,13	3,741,810	1,116,975
Letra me vlerë të maturuara	12,13	8,396,879	15,288,126
Investime në filiale	14	(21,250)	-
Blerje e aktiveve afatgjatë materiale	18	(677,058)	(1,744,778)
Të hyra nga shitja e aktiveve afatgjatë materiale		-	1,301
Blerje e aktiveve afatgjatë jomateriale	19	(32,285)	(29,375)
Flukset monetare neto nga aktivitetet investuese		(9,106,109)	(4,054,828)
Aktivitetet financuese			
Flukse hyrëse nga borxhi i varur	25	1,936,920	983,945
Flukse dalëse të borxhit të varur	25	(1,125,180)	(371,429)
Pagesa të financimeve të reja	24	(13,101)	(891,774)
Emetim i kapitalit		618,381	1,382,199
Flukset monetare neto nga aktivitetet financuese		1,417,020	1,102,941
Rritje në aktive monetare dhe ekuivalente me to		1,924,000	10,151,513
Aktive monetare dhe ekuivalente me to më 1 janar		29,040,607	18,889,094
Aktive monetare dhe ekuivalente me to, më 31 dhjetor		30,964,607	29,040,607

Shënimet 1 deri 35 në faqet 5 deri në 70 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

1 Informacion i Përgjithshëm

Banka Credins SHA (më poshtë referuar si “Banka” ose “Grupi”) është një institucion financiar Shqiptar i themeluar më 1 prill 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, miratuar në Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në dhjetor 1997, “Mbi Bankën e Shqipërisë” (këtej e tutje referuar si “Banka Qendrore”).

Me 31 dhjetor 2017, Banka ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet drejtorisë së përgjithshme të saj në Tiranë, 50 degëve në Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlorë, Shkodër, Korçë, Shijak, Shkozë, Kavajë, Lushnjë, Fushë Krujë, Kukës, Burrel, Ballsh, Berat, dhe si dhe 8 agjencive në Tiranë, Shkodër dhe Durrës (31 dhjetor 2016: 48 degë dhe 8 agjenci).

Aksionarët e Bankës kanë rënë dakord që Banka të blejë 76% të aksioneve me të drejtë vote të “CREDINS INVEST-sh.a-Shoqeri administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipermarrjeve të Investimeve Kolektive”, me pare “Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit “SiCRED” SHA” që zotëronte “SiCRED SHA”, nëpërmjet marrëveshjes së blerjes së aksioneve firmosur më 22 dhjetor 2014, për një shumë prej 60,000 mijë Lekë. Aprovimi për ndryshimin e strukturës së aksionarëve dhe ndryshimi i kontrollit të “Shoqërisë Administruese e Fondit të Pensionit “SiCRED” SHA” është dhënë nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare më 28 prill 2015. Ky ndryshim është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 10 qershor 2015, që është dhe data kur kontrolli mbi shoqërinë është bërë efektiv. Banka ka konsoliduar Shoqërinë duke filluar nga data 30 qershor 2015. Gjatë viteve Banka ka injektuar kapital të ri shtesë. Gjatë vitit 2017 shuma e kapitalit të ri të injektuar nga Banka është 6,080 mijë Lekë.

Aksionarët e Bankës kanë rënë dakord që Banka të blejë 95% të aksioneve të “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” SHA” për një vlerë prej 3,325 mijë Leke. Ky transaksion është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 16 mars 2016.

Aksionarët e Bankës kanë rënë dakord që Banka të blejë 42.5% të aksioneve të “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a.” për një vlerë prej 21,250 mijë Lekë. Ky transaksion është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 28 korrik 2017.

Më 31 dhjetor 2017, Banka kishte 872 punonjës (31 dhjetor 2016: 807 punonjës).

Adresa e zyrave qendrore të bankës dhe vendit kryesor të ushtrimit të aktivitetit është: Rr. Vaso Pasha Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.

2 Politikat Kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të matura me vlerë të drejtë.

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lek, i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(i) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”).

(ii) Paraqitja e pasqyrave financiare të konsoliduara

Banka e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (korrente), dhe më vonë se 12 muaj nga data e raportimit (jo korrente) paraqitet në shënimin 31.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Grupi gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Te ardhurat dhe shpenzimet nuk paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet, dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Bankës.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Politikat Kontabël(vazhdim)

2.2 Bazat për konsolidimin

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare të Mëmës dhe filialeve të saj më 31 dhjetor 2017. Kontrolli arrihet kur Mëma ekspozohet, ose i lind e drejta të përfitojë nga përfshirja e tij në filial, të ardhura të cilat mund të jenë të variushme, si dhe nëse ka aftësinë të afektojë këto rezultate nëpërmjet ndikimit të tij mbi filialin.

Specifikisht, Mëma kontrollon një filial, nëse dhe vetëm nëse, Mëma ka:

- Ndikim mbi filialin (p.sh: të drejta ekzistuese që i japin mundësinë të drejtojnë aktivitetet kryesore të filialit)

- Ekspozim ose i lind e drejta e përfuturit të rezultateve si rrjedhojë e përfshirjes së saj në filial
- Aftësinë për të ushtruar ndikimin e saj mbi filialin, për të ndikuar mbi rezultatet e ardhshme

Përgjithësisht, presumohet që kush ka shumicën e të drejtave të votës, ushtron kontrollin. Për të mbështetur këtë supozim, si dhe në rastet kur Mëma nuk ka shumicën e të drejtës së votës mbi një filial, Mëma konsideron të gjithë faktorët dhe rrethanat për të vlerësuar nëse ka ndikim mbi filialin, të tillë si:

- Marrëveshjet kontraktuale me të tjerë aksionere që kanë të drejta vote në filial
- Të drejta të cilat vijnë nga marrëveshje të tjera kontraktuale
- Të drejtat e votës së Grupit si dhe të tjera të drejta vote të mundshme

Mëma rivlerëson fakin nëse ajo kontrollon ose jo një filial, në bazë të fakteve dhe rrethanave të cilat diktojnë që mund të ketë ndryshime në një ose më shumë elemente të kontrollit. Konsolidimi i filialeve fillon kur Mëma merr kontrollin dhe mbaron kur Mëma e humbet këtë kontroll mbi filialin.

Aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e filialit të blerë ose të shitur gjatë vitit përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data që Mëma merr kontrollin deri në datën kur ajo e humbet atë.

Fitimi ose humbja dhe çdo element i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse i përkasin aksionerëve të mëmës si dhe interesave jo-kontrollues, edhe në rastin kur kjo sjell si pasojë një interes jo-kontrollues negativ. Në rastet që gjykohej e nevojshme, bëhen rregullime në pasqyrat financiare të filialeve për të sjellë politikën e tyre kontabël në linjë me politikën kontabël të përdorur nga Grupi. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, dhe aktivet, kapitali, të ardhurat dhe shpenzimet dhe flukset e parasë të lidhura me transaksione të ndodhura ndërmjet shoqërive të Grupit eliminohen plotësisht në konsolidim. Një ndryshim në interesin e zotëruar në një filial, që nuk sjell si pasojë humbjen e kontrollit, kontabilizohet si një transaksion me kapitalin.

Nëse Mëma humbet kontrollin mbi filialin, ai rregjistron të gjitha aktivet (duke përfshirë edhe emrin e mirë), detyrimet, interesin jo-kontrollues si dhe elementë të tjerë të kapitalit, duke njohur në fitim ose humbje cdo rezultat nga rregjistrimi. Çdo investim i mbajtur njihet me vlerë të drejtë.

a) Kombinimi i bizneseve dhe emri i mirë

Kombinimi i bizneseve kontabilizohet duke përdorur metodën e blerjes. Kostoja e blerjes matet si shuma e të gjithë vlerës së transferuar, e cila matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes si dhe me vlerën e çdo interesi jo-kontrollues në shoqërinë e blerë. Për cdo kombinim biznesi, Grupi zgjedh nëse do ta masë interesin jo-kontrollues me vlerë të drejtë ose me pjesën proporcionale të tij në aktivet neto të identifikueshme të shoqërisë së blerë. Kostot e lidhura me blerjen përfshihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin dhe konkretisht në zërin shpenzime administrative.

Kur Grupi blen një biznes, ai vlerëson aktivet financiare dhe detyrimet financiare të marra, për klasifikimin e përshtatshëm si dhe alokimin në përputhje me termit kontraktuale, rrethanat ekonomike dhe kushtet specifike në datën e blerjes. Çdo konsideratë e mundshme që do duhet të transferohet nga shoqëria blerëse, do të matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes. Konsiderata e mundshme që klasifikohet si aktiv ose detyrim si instrument financiar, dhe sipas qëllimit të SNK 39 Instrumentat financiarë: Njohja dhe matja, matet me vlerë të drejtë, dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politikat Kontabël

2.2 Bazat e përgatitjes

a) Kombinimi i bizneseve dhe emri i mirë

Emri i mire matet fillimisht me kosto (që rezulton nga tejkalimi i konsideratës së dhënë dhe vlerës së njohur për interesin jo-kontrollues) si dhe ndonjë interes tjetër mbi aktivet neto të identifikueshme dhe detyrimet e marra. Nëse vlera e drejtë e aktiveve neto të blera tejkalon shumën totale të konsideratës së transferuar, Mëma ri-vlerëson nëse i ka identifikuar saktë të gjitha aktivet e blera dhe të gjitha detyrimet e marra, si dhe rishikon procedurat e përdorura për të vlerësuar shumat për tu njohur në datën e blerjes. Nëse rivlerësimi rezulton sërish në tejkalim të konsideratës së transferuar, atëherë fitimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Pas njohjes fillestare, emri i mirë matet me kosto duke i zbritur çdo zhvlerësim të akumuluar. Për qëllim të testimit të rënies së vlerës, emri i mirë i përfutur nga kombinimi i biznesit, i alokohet çdo njësie gjeneruese të parasë së Grupit, që priten të përfitojnë nga kombinimi, pavarësisht nëse aktive dhe detyrime të tjera të shoqërisë së blerë i janë alokuar atyre.

2.3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël te Bankës, drejtimi ka ushtruar gjykim dhe vlerësim në përcaktimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara. Përdorimet më të rëndësishme të gjykimeve dhe vlerësimeve janë si vijon:

(I) Parimi i vijimësisë

Grupi kryen rregullisht “stress test-e”, për të testuar impaktin e mundshëm të indikatorëve makroekonomikë në pozicionin financiar, performancën dhe përputhshmërinë rregullatore. Këto “stress test-e” janë fokusuar kryesisht në impaktin që disa skenarë makro dhe mikroekonomikë mund të kenë në portofolin e kredisë, duke qenë burimi kryesor i të ardhurave të Bankës, pozicionit financiar duke përfshirë rrezikun e tregut. Gjatë këtij testimi përdoren modele zyrtare parashikuese të Bankës së Shqipërisë dhe vlerësime të brendshme të Bankës. Testet janë dinamike dhe kryhen për të vlerësuar efektin e mundshëm të ndikimit të rritjes/pakësimit të klientëve tek zërat e ndryshëm të pozicionit financiar, dhe të ardhurave dhe shpenzimeve, për një periudhë të caktuar kohore. Drejtimi i Bankës ka kryer një vlerësim të aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që Grupi ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Rrjedhimisht, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë, Për informacionin shpjegues rreth mjaftueshmërisë së kapitalit referohuni në notën 35.6.

(II) Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Grupi rishikon portofolet e saj të kredisë në baza mujore për të vlerësuar zhvlerësimin. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim ose humbje, Grupi bën gjykime për të parë nëse ka ndonjë të dhënë të vërtetueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset monetare të ardhshme të pritshme nga një portofol kredish para se rënia të mund të identifikohet me një kredi të konsoliduara në këtë portofol.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhënat e vërtetueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në një bankë, ose kushtet kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen me mosshlyerjen e huave nga huamarrësit.

Huatë të zhvlerësuara individualisht janë ato për të cilat ekziston një evidence objektive zhvlerësimi si:

- Huatë me më shumë se 45 ditëvonesa;
- Huatë e ristrukturuara (duke përjashtuar huatë e ristrukturuara në kategorinë standarde dhe në ndjekje);
- Huatë e biznesit me vlerësim B- dhe me poshtë;
- Huatë hipotekare me pike krediti 7 ose pa pikë;
- Huatë që kanë kolaterale të perbashkëta me huatë të zhvlerësuara individualisht.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.3 Significant accounting judgments, estimates and assumptions (continued)

(II) Impairment losses on loans and advances (continued)

Në llogaritjen e zhvlerësimit individual të huave merren në konsideratë faktorët e mëposhtëm: Shuma e kredive sipas standardeve IFRS; koha e ekzekutimit; norma e interesit; kolaterale të garantuara; kostoja e ekzekutimit të kolateraleve.

Kreditë të cilat nuk janë testuar individualisht për zhvlerësim dhe kredi që janë testuar individualisht dhe kanë rezultuar pa zhvlerësim, vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim. Kreditë e vlerësuara kolektivisht për zhvlerësim janë ato që nuk tregojnë evidencë objektive të rënies, dhe ato që vlerësohen individualisht por nuk krijojnë dëmtime të konsoliduara. Në dëmtimin kolektiv përfshihen edhe kreditë mikro dhe individët, të cilët sigurohen nga matrica e tranzicionit.

Zhvlerësimi në grup llogaritet në bazë të probabilitetit të humbjes për cdo sektor ekonomik. Probabiliteti i humbjes rishikohet cdo dy vite. Për secilën degë të industrisë, koeficienti i pritshëm i humbjes llogaritet si shuma e ekspozimit të humbur dhe kredive të shlyera, të ndara me shumën historike të miratuar për çdo degë të industrisë.

(III) Zhvlerësimi i investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje

Grupi shqyrton letrat e saj të borxhit të klasifikuara si investime në letra me vlerë të vlefshme për shitje në çdo datë të pasqyrave financiare për të vlerësuar nëse ato janë zhvlerësuar. Kjo kërkon gjykim të ngjashëm si ai i përdorur për vlerësimin individual të huave dhe paraqitjeve.

Grupi regjistron humbje nga zhvlerësimi i instrumentave të kapitalit të vlefshme për shitje kur ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur të vlerës së drejtë nën koston e tyre. Përcaktimi i asaj që është "i rëndësishëm" apo "i zgjatur" kërkon gjykim. Në marrjen e këtij vendimi, Grupi vlerëson, përveç faktorëve të tjerë, lëvizjet historike në çmimin e aksionit dhe kohëzgjatjen, si dhe masën në të cilën vlera e drejtë e një investimi është më e ulët se kostoja e tij.

2.4. Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet

2.4.1 Standarde të reja dhe interpretime

Grupi aplikoi për herë të parë disa standarde dhe ndryshime, të cilat janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. Grupi nuk ka miratuar më herët ndonjë standard, interpretim ose amendim tjetër që është lëshuar por nuk është ende efektiv.

Natyrë dhe efekti i këtyre ndryshimeve janë dhënë më poshtë. Megjithatë këto standarde dhe ndryshime të reja aplikoheshin për herë të parë në 2017, ato nuk patën një ndikim material në pasqyrat financiare vjetore të Bankës. Natyrë dhe ndikimi i çdo standardi të ri ose ndryshimi përshkruhet më poshtë:

• **SNK 7 Iniciativa për Shpallje - Amendime në SNK 7**

Amendimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parash janë pjesë e Inicativës së Publikimit të BSNK-së dhe ndihmojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një njësie ekonomike. Ndryshimet kërkojnë që njësitë ekonomike të japin informacion shpjegues për ndryshimet në detyrimet e tyre që rrjedhin nga aktivitetet e financimit, duke përfshirë të dy ndryshimet që rrjedhin nga flukset e mjeteve monetare dhe ndryshimet jo 'cash' (të tilla si fitimet ose humbjet në valutë të huaj). Në aplikimin fillestar të ndryshimit, subjekteve nuk u kërkohej të japin informacion krahasues për periudhat e mëparshme. Lejohet aplikimi i hershëm. Amendamentet synojnë të japin informacion për të ndihmuar investitorët të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një njësie ekonomike. Grupi ka zbatuar ndryshimin dhe ka paraqitur dhënie informacionesh shpjeguese shtesë rreth ndryshimeve në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit.

• **SNK 12 Njohja e Aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e përealizuara - Ndryshimet në SNK 12**

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. IASB ka nxjerrë ndryshimet në SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat për të sqaruar kontabilizimin për aktivet tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara mbi instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë. Amendamentet sqarojnë se një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë nëse ligji tatimor kufizon burimet e fitimeve të tatueshme, ndaj të cilave mund të bëjë zbritje për kthimin e kësaj difference të përkohshme të zbritshme. Për më tepër, ndryshimet sigurojnë udhëzime se si një njësi ekonomike duhet të përcaktojë fitimet e tatueshme të ardhshme dhe të shpjegojë rrethanat në të cilat fitimi i tatueshëm mund të përfshijë rikuperimin e disa pasurive për më shumë sesa vlera e tyre kontabël. Subjekteve u kërkohej të aplikojnë ndryshimet në mënyrë retrospektive.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.4 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

2.4.1 Standarde të reja dhe interpretime (vazhdim)

• **SNK 12 Njohja e Aktiveve tatimore të shtyra për Humbjet e parealizuara - Ndryshimet në SNK 12**

Megjithatë, në aplikimin fillestar të ndryshimeve, ndryshimi në kapitalin fillestar të periudhës krahasuese më të hershme mund të njihet në fitimet e pashpërndara të hapura (ose në një pjesë tjetër të kapitalit neto, sipas rastit), pa akorduar ndryshimin midis fitimit të pashpërndarë të hapur dhe komponentëve të tjerë të barazisë. Subjektet që aplikojnë këtë lehtësim duhet ta zbulojnë këtë fakt. Lejohet aplikimi i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta zbulojë atë fakt. Ndryshimet synojnë të heqin divergjencën ekzistuese në praktikë në njohjen e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara. Ky ndryshim nuk është i zbatueshëm për Bankën.

• **Deklarata e praktikave të SNRF 2: Marrja e vendimeve të materialitetit**

Subjekteve u lejohet të zbatojnë udhëzimet në Deklaratën e Praktikës (DP) në pasqyrat financiare të përgatitura në çdo kohë pas datës 14 shtator 2017. DP përmban udhëzime jo të detyrueshme për të ndihmuar njësitë ekonomike që të japin gjykime materialiteti gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme. Gjithashtu, DP mund të ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare për të kuptuar se si një njësi ekonomike bën gjykime të materialitetit në përgatitjen e pasqyrave financiare. DP përmban udhëzime në tri fusha kryesore:

• Karakteristikat e përgjithshme të materialitetit

• Një proces me katër hapa që mund të zbatohet në bërjen e gjykimeve të materialitetit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Ky proces përshkruan se si një njësi ekonomike mund të vlerësojë nëse informacioni është material për qëllimet e njohjes, matjes, prezantimit dhe zbulimit.

• Si të bëhen gjykimet e materialitetit në rrethana specifike, domethënë, informacionet e mëparshme, gabimet dhe kushtëzimet dhe në kontekstin e raportimit të përkohshëm.

Për më tepër, DP diskuton ndërveprimin ndërmjet vendimeve të materialitetit që një entitet duhet të bëjë dhe ligjet dhe rregulloret vendore. DP përfshin shembuj që ilustrjnë se si një njësi ekonomike mund të zbatojë udhëzimet. Meqenëse DP është një dokument jo i detyrueshëm, ai nuk ndryshon ose nuk paraqet ndonjë kërkesë në SNRF. Sidoqoftë, DP siguron udhëzime të dobishme për subjektet që bëjnë gjykime të materialitetit dhe në këtë mënyrë mund të përmirësojnë efektivitetin e komunikimit të pasqyrave financiare. Grupi ende nuk ka bërë asnjë gjykim të materialitetit.

Përmirësimet vjetore 2014-2016 Cikli (lëshuar në dhjetor 2016)

Këto përmirësime përfshijnë:

• **SNRF 1 Adoptimi per herë të Parë për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar - Heqja e përjashtimeve afatshkurtra për adoptuesit e pare**

Përjashtimet afatshkurtra në paragrafët E3-E7 të SNRF 1 u fshinë sepse ata tani kanë shërbyer qëllimin e synuar. Amendimi hyn në fuqi që nga 1 janari 2018. Ky ndryshim nuk zbatohet për Bankën.

• **SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta - Sqarim që matja e të investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje që vlerësohet investim pas investimi**

Amendamentet sqarojnë se:

• Një njësi ekonomike që është një organizatë kapitalesh sipërmarrëse ose një njësi tjetër kualifikuese, mund të zgjedhë, në njohjen fillestare në bazë të investimeve për investime, të matë investimet e saj në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

• Nëse një njësi ekonomike, që nuk është në vetvete një njësi ekonomike investuese, ka një interes në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që është një njësi ekonomike investuese, njësia ekonomike mundet, gjatë zbatimit të metodës së kapitalit neto, të zgjedhë të mbajë matjen e vlerës së drejtë të zbatuar nga ajo njësi ekonomike investuese pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në interesat e shoqërive ose sipërmarrjeve të njësisë ekonomike investuese në filiale. Këto zgjedhje bëhen veçmas për secilën shoqëri ose sipërmarrje të njësisë ekonomike investuese, më vonë se data në të cilën: (a) njësia ekonomike investuese ose ndërmarrja e përbashkët njihet fillimisht; (b) shoqëria ose ndërmarrja e përbashkët bëhet një njësi ekonomike investuese; dhe (c) shoqëria e investimit ose pjesëmarrja e përbashkët kur kthehet në shoqëri kontrolluese. Amendamentet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe të jenë në fuqi nga 1 janari 2018, por janë të lejuara të aplikohen edhe më herët. Nëse një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta shpalosë atë fakt. Këto ndryshime nuk janë të zbatueshme për Bankën.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.4 Ndryshimet ne politikat kontabël dhe shpjegimet (vazhdim)

2.4.1 Standarde të reja dhe interpretime (vazhdim)

Përmirësimet vjetore 2014-2016 Cikli (lëshuar në dhjetor 2016) (vazhdim)

- **SNRF 12 Shpalosja e Interesave në Njësitë e tjera**

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit në investimet e borxhit të vlefshme për shitje, njihen direkt në humbje ose fitim. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar të njihet në fitim ose humbje.

(c) Të mbajtur për tregtim

Një aktiv financiar klasifikohet si i mbajtur për tregtim nëse:

- është blerë kryesisht për qëllimin e shitjes në një kohë të afërt; ose
- në njohjen fillestare është pjesë e një portofoli të instrumenteve financiare të identikuara që Grupi i menaxhon së bashku dhe ka një model të fundit aktual të fitimit afatshkurtër; ose
- është një derivativ që nuk është përcaktuar dhe efektiv si një instrument mbrojtës.

Këto aktive financiare janë të shprehura me vlerën e drejtë, me çfarëdo fitimi ose humbje që rrjedh nga rivlerësimi i njohur në fitim ose humbje. Fitimi ose humbja neto e njohur në fitim ose humbje përfshin çdo dividend ose interes të fituar mbi aktivin financiar.

d) Derivatet e regjistruara me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Grupi hyn në transaksione derivative me palë të ndryshme. Këto përfshijnë këmbimet e normave të interesit, të ardhmes, këmbimet e kredive të huaja, këmbimet valutore, kontratat e këmbimit valutor dhe opsionet mbi normat e interesit, valutave dhe kapitaleve të huaja. Derivatet regjistrohen me vlerën e drejtë dhe mbarten si aktive kur vlera e tyre e drejtë është pozitive dhe si pasive kur vlera e tyre e drejtë është negative. Derivatet e përfshirë në instrumente të tjerë financiarë trajtohen si derivativë të veçantë dhe regjistrohen me vlerën e drejtë nëse plotësojnë përkufizimin e një derivativi (siç përcaktohet më sipër), karakteristikat e tyre ekonomike dhe rreziqet nuk janë të lidhura ngushtë me ato të kontratës bazë dhe kontrata bazë nuk është e mbajtur për tregtim ose e caktuar në kategorinë e 'vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes'. Derivatet e përfshirë të ndare nga kontrata bazë mbahen me vlerën e drejtë në portofolin tregtar me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohur në pasqyrën e të ardhurave.

(vii) Borxhi i emetuar dhe fonde të tjera të marra borxh

Instrumentat financiarë të emetuara nga Grupi, që nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë klasifikuar si "borxhi i varur", ku substanca e marrëveshjes kontraktuale rezulton në atë që Grupi ka një detyrim për t'i shlyer mbajtësit, nëpërmjet mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare, ose të përmbushë detyrimin nëpërmjet një mënyre tjetër përveçse duke këmbyer një shumë të caktuar parash ose aktive të tjera financiare për një numër fiks aksionesh në kapitalin e vet.

Pas matjes fillestare, borxhi i emetuar dhe huamarrjet e tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Një analizë e borxhit të emetuar të Bankës është paraqitur në Shënimin 24.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3) Mosnjohja (çregjistrimi) e aktiveve dhe detyrimeve financiare

(i) Aktivet financiare

Grupi nuk e njeh më një aktiv financiar (e çregjistron) nëse të drejtat kontraktuale për përfitimin e parave nga aktiviteti janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktiviteti financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen te një njësi tjetër të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Grupi njihet si një aktiv ose detyrim më vete. Grupi kryen transaksione nëpërmjet të cilëve transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose një pjesë të rreziqeve ose shpërblimeve të aktiveve të transferuara. Në rast se Grupi mban të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve, ndërkohë që mbahen të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme, përfshijnë për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi "swap" për aktivet e transferuara, transaksioni kontabilizohet si një transaksion financimi i sigurt i njëjtë me transaksionet e riblerjes. Për transaksionet ku Grupi as nuk mban dhe as nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet aktuale ose të mëvonshme që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo nuk e njeh (çregjistron) aktivin në rast se nuk ka kontroll mbi të. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen gjatë transferimit njihen më vete si aktive dhe detyrime, sipas rastit. Në ato transferime ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Grupi vazhdon të njohë aktivin për atë kohë sa ky aktiv rezulton i përfshirë, gjë e cila përcaktohet nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në transaksione të caktuara Grupi mban të drejtat e shërbimit ndaj një aktiviteti financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktiviteti i transferuar çregjistrohet tërësisht nëse plotëson kriteret e mosnjohjes.

(ii) Detyrimet financiare

Grupi çregjistron detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur, detyrimet e Grupit janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël neto të detyrimit financiar të çregjistruar dhe shumës së paguar dhe të pagueshme njihet në fitim ose humbje.

Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat e shërbimit, në qoftë se tarifa e shërbimit është më e lartë se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

(4) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbëhet ose një detyrim të shlyhet midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën, të mirinformuara që kryejnë një transaksion në mënyrë të vullnetshme në datën e matjes.

Kur është e mundur, Grupi e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksione të tregut aktual që kryhen në mënyrë të rregullt dhe në kushte të barabarta. Një teknikë vlerësimi e përdorur nga Grupi për të identifikuar nëse për një instrument financiar ekziston një treg aktiv është ekzistenca e çmimeve të kuotuar për aktive dhe/ose detyrime të ngjashme, të cilat Grupi mund t'i aksesojë në datën e raportimit. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Grupi kryen matjen me vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve më të fundit të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të mirinformuara të palidhura me njëra-tjetrën (nëse është e disponueshme), lidhur me vlerën e drejtë aktuale të instrumentave të tjerë që janë kryesisht të njëjtë, flukset monetare të skontuara dhe modelet e vlerësimit të opsioneve. Teknika e zgjedhur e vlerësimit bazohet maksimalisht te të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në llogaritjet specifike të Bankës, bashkon të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg konsiderojnë në vendosjen e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë ekonomike të pranueshme për vendosjen e çmimit për instrumentat financiare. Të dhënat për teknikat e vlerësimit paraqesin pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentat financiarë.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(4) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Grupi kalibron metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmëri duke përdorur çmime të vëzhguara në transaksionet aktuale të tregut në instrumenta të njëjtë ose në të dhëna të tjera të vëzhgueshme në treg. Evidence më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e dhënë ose e marrë, vetëm nëse vlera e drejtë e atij instrumenti është evidentuar nga krahasimi me transaksione aktuale të tregut për instrumenta të njëjtë (p.sh., pa modifikime ose ripaketim) ose e bazuar në metodat e vlerësimit në të cilat variablat përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur çmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të përfutur nga një model vlerësimi është njohur më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni të mbyllet.

Aktivitet dhe pozicionimet afatgjata maten me çmimin e ofruar, detyrimet dhe pozicionimet afatshkurtra maten me çmimin e kërkuar. Kur Grupi ka një pozicionim me rreziqe që kompensojnë njëri tjetrin, çmime “mid-market” janë përdorur për të matur pozicionin e rreziqeve të kompensuar dhe një çmim i kërkuar ose ofertë rregullimi është aplikuar vetëm tek pozicionet e hapura neto. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin rregullime të cilat marrin parasysh rrezikun e kreditimit të Bankës dhe të palës tjetër kur është e përshtatshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë të përfutura nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Grupi beson që një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do i merrte ato në konsideratë për vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Grupi e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme që reflekton rëndësinë e input-eve të përdorura gjatë matjeve:

- Niveli 1: çmimet e kuotuar (te pakorrigjuara) të një tregu aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në input-e të vëzhgueshme, ose në mënyrë direkte (si p.sh çmimet), ose në mënyrë indirekte (që rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: çmime të kuotuar në tregje aktivë për instrumenta identikë ose të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumenta identikë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen jo aq aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku gjithë input-et kryesore mund të vëzhgohen në mënyrë direkte ose indirekte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur input-e të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku teknika e vlerësimit përfshin input-e që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe input-et jo të vëzhgueshme kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen mbi bazën e çmimeve të kuotuar për instrumenta të ngjashëm ku kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar diferencat mes instrumentave.

(5) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në çdo datë bilanci Grupi vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuar kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Grupi konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk zhvlerësohen specifikisht vlerësohen kolektivisht për çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidencë objektive që aktivet financiare të zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Grupi me kusht që Grupi nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(5) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Grupi përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

(i) Aktivët financiarë me kosto të amortizuar

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizioni kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdon të njihet përmes rikthimit të zbritjes. Kur një ngjarje e mëvonshme bën që shuma e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, humbja nga zhvlerësimi kthehet (n njihet) nëpërmjet fitimit ose humbjes.

(ii) Instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje

Për instrumentat financiarë të vlefshëm për shitje, Grupi vlerëson në çdo datë të pasqyrave financiare nëse ka evidencë objektive që një investim është zhvlerësuar. Humbjet nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje njihen duke transferuar përmes një riklasifikimi, humbjen kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, në fitim ose humbe. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera, në fitim ose humbje, është diferenca midis kostos së blerjes, neto nga çdo shlyerje principali dhe amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë në fitim ose humbje. Ndryshimet në provizionet për zhvlerësim që i atribuohen vlerës në kohë janë pasqyruar si një komponent i të ardhurave nga interesi.

Nëse në një periudhë të mëvonshme vlera e drejtë e një letrë me vlerë të vlefshme për shitje që është zhvlerësuar rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim ose humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet (rimerret), dhe shuma e kthimit njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, çdo rritje e mëvonshme në vlerën e drejtë të një letrë me vlerë të zhvlerësuar të kapitalit njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse.

(iii) Kreditë e rinegociuara

Kur është e mundur, Grupi kërkon të ristrukturojë kreditë në vend që të marrë në zotërim kolateralet. Kjo mund të përfshijë shtrirjen e afatit të pagesave dhe rënien dakord për kushte të reja të kredisë. Pasi kushtet janë rinegociuar, ndonjë zhvlerësim i mundshëm matet duke përdorur normën fillestare efektive të interesit, të llogaritur para modifikimit të termave dhe kredia nuk konsiderohet më me vonesë. Drejtimi vazhdimisht rishikon kreditë e rinegociuara për t'u siguruar që të gjitha kriteret janë përmbushur dhe se pagesat e ardhshme ka të ngjarë të ndodhin. Kreditë vazhdojnë të jenë subjekt i një vlerësimi individual apo kolektiv nga zhvlerësimi, i llogaritur duke përdorur normën fillestare efektive të interesit të kredisë.

(6) Kompensimi i instrumentave financiarë

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë, kur Grupi ka të drejtën ligjore për të kompensuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Bankës.

(7) Matja me kosto të amortizuar e instrumentave financiarë

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(8) Qiratë financiare ("leasing")

Përcaktimi nëse një marrëveshje është qira, ose ajo përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve specifike dhe marrëveshja mbart të drejtën për të përdorur aktivin.

Grupi si një qiramarrës

Qiratë që nuk transferojnë te Grupi në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendeve me qira janë qira operacionale. Pagesat e qirasë operacionale njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë ("leasing"). Qiratë e pagueshme njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato ndodhin.

Grupi si një qiradhënës

Qiratë ku Grupi transferon rrezikun dhe përfitimet e pronësisë së aktivit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e gjendjes financiare, Grupi paraqet në pasqyrën e pozicionit financiar shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën neto të investimit. Njohja e të ardhurave financiare do të bazohet në një model që pasqyron një normë konstante periodike të kthimit të investimit neto të qiradhënësit mbi qiranë financiare. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, i janë zbritur investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin (kryegjënë), ashtu edhe të ardhurat financiare të pafituara.

Të ardhurat nga shitja të njohura nga prodhuesi ose tregtari qiradhënës në fillim të afatit të leasing-ut janë vlera e drejtë e aktivit, ose, nëse më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të leasing-ut që i takojnë qiradhënësit, llogaritur me normën e interesit të tregut.

(9) Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat njihen në atë masë që është e mundur që përfitimet ekonomike do të rrjedhin në bankë dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret e mëposhtme specifike të njohjes gjithashtu duhet të plotësohen para se të ardhurat njihen.

(i) Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

(ii) Interest income and expense (continued)

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë përdorimi të një mjeti apo detyrimi financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të paraqitura si fitim ose humbje përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive.

(iii) Të ardhurat dhe shpenzimet për komisione dhe tarifa

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifën e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet. Shpenzime të tjera për tarifën dhe komisionet që lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh dhe shërbimi shpenzohen në momentin që ofrohen shërbimet.

(10) Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to

Aktivet monetare dhe ekuivalentët me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha, shuma të pakushtëzuara me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël, të cilat janë subjekt i rreziqeve të parëndësishme të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga Grupi në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Aktivët monetare dhe ekuivalentët me to mbarten me koston e amortizimit në pasqyrën e pozicionit financiar.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(11) Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimeve fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe më pas mbarten në varësi të klasifikimit të tyre, si të mbajtura për tregtim apo deri në maturim, me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ose të vlefshme për shitje.

(12) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivët afatgjata materiale maten me koston e blerjes minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitetit. Kostot e aktiveve të ndërtuara vetë përfshijnë kostot e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivitetit në punë për qëllimin e përcaktuar dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes dhe ristrukturimin në vendin në të cilin ato ndodhen. Programi kompjuterik i blerës, i cili është një pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kontabilizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesët e një zëri të ndërtesës dhe pajisjeve kanë jetë përdorimi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndarë (komponentët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e pjesëve të zëvendësuara të tokës, ndërtesës dhe pajisjeve njihet me vlerën e mbartur nëse është e mundshme që ne të ardhmen Grupi do të ketë përfitime ekonomike nga këto pjesë dhe kostot e tyre mund të njihen në mënyrë të besueshme. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur lindin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura dhe shpenzimeve me anën e metodës së vlerës së mbetur mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivitetit përveçse për aktivet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivët e marra me qira zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit. Toka nuk zhvlerësohet. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në datën e raportimit.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve afatgjata	% e amortizimit	Metoda e amortizimit
Ndërtesa	5%	Linear
Pajisje elektronike	25%	Mbi vlerën e mbetur
Automjete	20%	Mbi vlerën e mbetur
Mobilie dhe pajisje zyre	20%	Mbi vlerën e mbetur
Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	5%	Linear

(13) Aktivët jomateriale

(i) Programe kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Grupi njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Amortizimi njihet në fitim ose humbje me normën 25% mbi vlerën e mbetur prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim.

(ii) Licencat

Licencat dhe të drejtat e përdorimit blerë nga Grupi janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi nëse ka. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm atëherë kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare mbi jetën e dobishme të licencës që nga data që është e vlefshme për përdorim.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(14) Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësia gjeneruese e mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese të mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë kryesisht të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen si fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

(15) Garancitë Financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

(16) Përfitimet e punonjësve

(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Grupi paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Grupi njih si detyrim shumën e përlogaritur të kostos për lejet vjetore që pritët të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

(iii) Sigurimet shëndetësore të punonjësve

Grupi gjithashtu paguan kontribute të përcaktuara për sigurimin shëndetësor të punonjësve. Kontributi është i pagueshëm ndaj një kompanie sigurimi në raport me shërbimet e kryera në bankë nga ana e punonjësve dhe është regjistruar si një shpenzim nën 'shpenzime të personelit'. Kontributet e papaguara janë të regjistruar si detyrime.

(iv) Kontribut vullnetar i pensionit për punonjësit

Grupi ka krijuar një Plan Pensioni Profesional për punonjësit e vetë. Bank merr përsipër të paguajë kontribute për cdo punonjës që ka firmosur një kontratë individuale për "Planin Profesional të Pensionit." Shpenzimi vjetor përfaqëson kontributin vjetor të paguar nga Grupi, dhe regjistrohet në zërin "Shpenzime Personeli," duke prekur pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të Bankës, dhe pa ndikuar në detyrimet e mëvonshme të Bankës,

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(17) Provizione për detyrime të kushtëzuara dhe angazhime

Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare të ardhshme me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme, rreziqet specifike që lidhen me detyrimin.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Grupi ka miratuar një plan të detajuar dhe formal ristrukturimi, dhe ristrukturimi ose ka filluar ose është shpallur publikisht. Shpenzimet operative të ardhshme nuk janë provizionuar.

Një provizion për kontratat e dyshimta njihet kur përfitimet që priten të rrjedhin te Grupi nga një kontratë janë më të ulëta se sa kostoja e pashmangshme e përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet me më të ultën mes vlerës aktuale të kostos së pritshme nga ndërprerja e kontratës dhe kostos së pritshme neto të vazhimit me kontratën. Para se të njihet provizioni, Grupi njezh çdo humbje nga zhvlerësimi mbi aktivet e lidhura me atë kontratë.

(18) Tatimet

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

(i) Tatimi aktual mbi fitimin

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm vjetor. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në Pasqyrën e të Ardhurave Përmbledhëse për shkak të zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshëm ose të zbritshëm në periudhat e ardhshme dhe zërat që nuk tatohen apo njihen si të zbritshëm asnjëherë.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin njihen në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Të ardhurat e tatueshme llogariten duke rregulluar fitimin para tatimit për shumën e të ardhurave shpenzimeve të caktuara, siç kërkohej nga ligji Shqiptar.

(ii) Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës kontabël të përdorura për qëllim fiskale. Detyrimet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivet tatimore të shtyra njihen në përgjithësi për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë të disponueshme, ndaj të cilave ato mund të shfrytëzohen. Vlera kontabël neto e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në fund të çdo periudhe raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që nuk është e mundur që të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme në dispozicion për të lejuar që e gjitha ose një pjesë e aktivitetit të mund të rikuperohet.

Detyrimet dhe aktivet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në periudhën kur detyrimi do të shlyhet ose aktivi realizohet, bazuar në normat fiskale dhe ligjet fiskale të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit. Matja e detyrimeve dhe aktiveve tatimore të shtyra pasqyron rrjedhojat tatimore që do të vijojnë nga mënyra në të cilën Grupi pret, që në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

(iii) Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin

Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje, përveç kur lidhen me zërat që janë njohur në të ardhurat e tjera përmbledhëse, ose direkt në kapital, rast në të cilin tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen edhe në të ardhurat e tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, përkatësisht.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

2 Politika Kontabel (vazhdim)

2.5 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(19) Prona të riposeduara

Politika e Bankës është të përcaktojë nëse një aktiv i riposeduar do të përdoret për përdorim të brendshëm nga Grupi apo do të shitet. Aktivet e përcaktuara si të dobishme për aktivitetet e brendshme të Bankës transferohen në klasën përkatëse të aktiveve me vlerën më të ulët mes vlerës së riposedimit dhe vlerës kontabël të aktivit fillestar të siguruar.

Grupi zotëron disa prona të riposeduara të cilat i ka marrë nga ekzekutimi i kolateraleve të huave dhe paradhënies ndaj klientëve. Grupi i mat keto aktive të riposeduara fillimisht me kosto (çmim blerje). Në fund të çdo periudhe raportuese keto aktive maten me me të voglen mes koston dhe vlerën neto të realizueshme. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga çdo ndryshim në vlerën neto të realizueshme të pronave të riposeduara njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën lindin. Keto aktive çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga ky pakësim (nxjerrje jashtë përdorimit). Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja e pronës (llogaritur si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të aktivit) përfshihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën prona është çregjistruar.

(20) Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur janë burimet kryesore të financimit të Bankës. Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një "marrëveshje riblerjeje" për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Grupi zgjedh që t'i mbajë detyrimet me vlerën e drejtë në fitim ose humbje. Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe i alokimit të shpenzimit të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skanton deri në vlerën kontabël neto në njohjen fillestare, pagesat monetare të ardhshme të vlerësuar (përfshirë të gjitha taksat dhe shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose zbritjet) përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose (sipas rastit) përgjatë një periudhe më të shkurtër.

(21) Dividendët

Dividendët e aksioneve të zakonshme janë njohur si një detyrim dhe janë zbritur nga kapitali në momentin kur ata janë miratuar nga aksionarët e Bankës.

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016, nuk ka patur dividend të deklaruar nga Grupi për tu paguar aksionareve.

(22) Rezervat e kapitalit

Rezervat e regjistruara në kapital (të ardhurat e tjera përmbledhëse) në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë:

"Rezervën e përgjithshme" që përfshin ndryshimet e bëra për rezervën ligjore siç përcaktohet në Ligjin e Bankës Qendrore dhe Ligjin Tregtar të zbatueshëm në Shqipëri.

"Rezerva e rivlerësimit" e cila është përdorur për të regjistruar ndryshimet e këmbimit që rrjedhin nga rivlerësimi i letrave me vlerë të investimit.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

3 Të ardhura neto nga interesat

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat		
Hua dhe paradhënie për klientët	7,598,753	8,028,614
Letra me vlerë të vlefshme për shitje	829,307	870,518
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	71,689	15,663
Hua dhënë bankave	25,157	38,611
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	50,738	63,665
Të ardhura nga interesat e përlogaritura mbi aktivet financiare të zhvlerësuar	172,109	185,162
Totali i të ardhurave nga interesat	8,747,753	9,202,233
Shpenzimet për interesa		
Detyrime ndaj bankave	(106,322)	(111,821)
Detyrime ndaj klientëve	(1,285,722)	(1,628,406)
Borxhi i varur	(453,996)	(418,970)
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	(8,210)	(3,870)
Totali i shpenzimeve për interesa	(1,854,250)	(2,163,067)
Të ardhura neto nga interesat	6,893,503	7,039,166

4 Të ardhura dhe shpenzime nga tarifat dhe komisionet

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		
Komisione nga shërbimet bankare	799,366	638,515
Tarifa dhe komisione nga shërbimet e huadhënies	43,784	19,132
Totali i të ardhurave nga tarifat dhe komisionet	843,150	657,647
Shpenzime për tarifa dhe komisione		
Tarifa për veprime ndërbankare	(38,385)	(48,074)
Veprime me thesarin	(42,516)	(49,461)
Të tjera	(36,542)	(13,853)
Totali i shpenzimeve për tarifa dhe komisione	(117,443)	(111,388)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	725,707	546,259

5 Të ardhura dhe shpenzime të tjera

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura të tjera		
Të ardhura të tjera	403,281	202,064
Totali i të ardhurave të tjera	403,281	202,064
Shpenzime të tjera		
Shpenzime të tjera të lidhura me aktivitetet bankare	(582,541)	(169,556)
Shpenzime të tjera	-	(44)
Totali i shpenzimeve të tjera	(582,541)	(169,600)
Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto	(179,260)	32,464

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 përfshijnë shpenzime që lidhen me aktivitetet bankare, me rënien në vlerë të pronave të riposduara, shpenzim i cili më 31 dhjetor 2017 është në shumën 497,357 mijë Lekë (31 dhjetor 2016: 52,000 mijë Lekë) (shënimi 17).

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

6 Shpenzime personeli

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pagat e punonjësve	851,693	766,980
Sigurime shoqërore	113,764	100,195
Bonus dhe shpërblime	81,915	106,292
Sigurimet Shëndetësore	16,142	19,539
Të tjera	138,590	84,726
	1,202,104	1,077,732

7 Shpenzime administrative

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Sigurime dhe mbikëqyrje	505,423	519,056
Tarifa për palë të treta	473,866	320,721
Qira	441,476	499,617
Marketing dhe abonime	213,086	327,279
Mirëmbajtje	163,999	139,508
Ujë, energji	55,004	49,640
Pajisje	54,880	54,143
Transport dhe udhëtime	32,444	31,829
Të tjera	58,904	47,635
Taksa lokale dhe të tjera	41,552	34,608
	2,040,634	2,024,036

Sigurimi dhe mbikqyrja si dhe shpenzimet për qeratë dhe mirembajtja kanë rënë si rezultat i zhvlerësimit të monedhave të huaja ndaj Lek-ut dhe mbylljes së disa marrëveshjeve të qirasë gjatë vitit. Shpenzimet e marketingut kanë rënë për shkak të luhatshmërisë që lidhet me këto lloj shpenzimesh. Gjithashtu ka patur rritje në numrin e kartave Visa Cards të lëshuara dhe numrit të transaksioneve të kryera nëpërmjet pikave të ATM-ve dhe POS-eve.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

8 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Tatimi aktual	340,392	169,587
Tatim fitimi i shtyre (shënimi 17)	(74,604)	(7,800)
Tatimi mbi fitimin	265,788	161,787

Shpenzimet e zhvlerësimit të njohura nga Grupi në përputhje me SNRF do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme për efekt tatimi, me kusht që ato të jenë certifikuar nga një auditues i jashtëm. Në përputhje me legjislacionin tatimor në Shqipëri, norma e aplikueshme e tatimit mbi fitimin për 2017 është 15% dhe 2016 është 15%.

Përfitimi tatimor i shtyrë llogaritet në vlerën e pronave të riposeduara (shënimi 17).

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin është përmbledhur si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	1,337,528	416,416
Tatim fitim i llogaritur si 15% (2016: 15%) e fitimit kontabël	200,629	62,463
Tatim i fitimit mbi humbjet e pazbritshme të investimit në pjesëmarrje	795	-
Tatim i fitimit mbi humbjet e pazbritshme të shoqërive të kontrolluara	1,167	1,548
Tatim i fitimit mbi shpenzimet e pazbritshme	137,801	105,576
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	340,392	169,587

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit tek Autoritetet Tatimore por fitimet ose humbjet e deklaruarat për qëllime fiskale konsiderohen provizore derisa deklaratat tatimore dhe llogaritjet e tatimit të inspektohen nga autoritetet tatimore dhe një vlerësim final të lëshohet. Legjislacioni shqiptar mbi tatimin është subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore. Shpenzimet e panjohura përfshijnë humbje nga kreditë e pambledhshme, rënie vlere të pronave të riposeduara, provigjonet e krijuara, shpenzimin e amortizimit për përmirësimet e ambjentëve me qera të cilat nuk njihen për efekte fiskale, dhe shpenzime të tjera të panjohura sipas legjislacionit fiskal në fuqi

9 Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Llogarite rrjedhëse me bankat	2,662,593	4,819,253
Vendosjet në tregun e parasë	6,033,303	5,770,777
Aktive monetare në arkë	3,859,274	5,183,873
Llogarite rrjedhëse të pakushtëzuara me Bankën Qendrore	19,315,361	14,387,231
Në tranzit	(905,924)	(1,120,527)
	30,964,607	29,040,607

Vendosjet në tregun e parasë përfshijnë vendosjet me bankat rezidente dhe jo-rezidente, me maturitet afatshkurtër, deri në 3 muaj.

Mjetet monetare në tranzit përfaqësojnë pagesa ndaj Autoriteteve Tatimore të kryera nga klientë të Bankës, për të cilat Grupi vepron si agjent për mbledhjen e tyre. Këto transaksione janë kryer brenda datës 31 Dhjetor 2017, dhe mbyllen me transferimin e vlerave tek llogaria rrjedhëse e Bankës me Bankën Qendrore në ditët e para të vitit 2018.

Më 31 dhjetor 2017, Banka ka 2,609,701 mijë lekë, 79,145 mijë Euro (10,506,393 mijë) dhe 55,783 mijë USD (6,197,507 mijë lekë) në llogaritë rrjedhëse me Bankën qendrore. Këto shuma nuk bartin interes dhe paguhen sipas kërkesës.

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

10 Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore lidhur me rezervën e depozitave, Grupi duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve në Bankën Qendrore si një llogari rezervë. Bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 29 datë 16.05.2012 Grupi mund të përdorë rezervën e kërkuar në lekë nëse bilanci mesatar i fundvitit në llogarinë e rezervës 2017 gjatë periudhës së mbajtjes nuk është më i vogël se shuma e përcaktuar për rezervën e kërkuar. Maturimi i rezervës së detyrueshme llogaritet në baza mujore dhe rezerva në lekë është 70% e normës REPO njëvjeçare (norma bazë) në Shqipëri, e cila më 31 dhjetor 2017 ishte 1.25% (31 dhjetor 2016: 1.25%). Rezerva e shprehur në euro përfaqëson një normë interesi që është e barabartë me normën e depozitave të shpallur nga Banka Qendrore Evropiane e cila më 31 dhjetor 2017 ishte -0.4% (31 Dhjetor 2016: -0.4%). Rezerva e shprehur në dollarë amerikane nuk ka interes.

Më 31 dhjetor 2017, bilanci i parave të gatshme të kufizuara është 11,352,440 mijë lekë (31 dhjetor 2016: 11,520,723 mijë lekë).

11 Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Bankat dhe institucione e tjera financiare jo-rezidente	116,537	1,351,174
<i>Në monedhë të huaj</i>	116,537	1,351,174
Bankat dhe institucionet e tjera financiare rezidente	78,069	183,972
<i>Në lekë</i>	57,997	153,636
<i>Në monedhë të huaj</i>	20,072	30,336
Totali	194,606	1,535,146

12 Letrat me vlerë të investimit të mbajtura për tregtim

Letrat me vlerë të investimit të mbajtura për tregtim më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Bono Thesari	76,393	-
Obligacione qeveritare	289,336	-
Derivate – Opsione shitje	84,991	-
Total	450,720	-

Bono thesari

Normat efektive të interesit për bonot e thesarit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 kanë qenë 2.65%. Detajet e bonove të thesarit më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, duke treguar maturimin e tyre fillestar, vlerën e tyre kontabël dhe vlerën e drejtë përkatëse në datën e raportimit, sipas llojit janë paraqitur si më poshtë:

		31 dhjetor 2017				
		<i>Vlera nominale</i>	<i>Zbritja e shtyrë</i>	<i>Interesi i përlllogaritur</i>	<i>Vlera e amortizuar</i>	<i>Diferenca e rivlerësimit</i>
12 muaj		78,000	(2,008)	292	76,284	109
		78,000	(2,008)	292	76,284	109
		31 dhjetor 2016				
		<i>Vlera nominale</i>	<i>Zbritja e shtyrë</i>	<i>Interesi i përlllogaritur</i>	<i>Vlera e amortizuar</i>	<i>Diferenca e rivlerësimit</i>
12 muaj		-	-	-	-	-
		-	-	-	-	-

Banka Credins sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(shumat në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

12 Letrat me vlerë të investimit të mbajtura për tregtim (vazhdim)

Obligacione qeveritare

Më 31 dhjetor 2017, Grupi kishte një portofol të obligacioneve qeveritare 5-vjeçare dhe 10-vjeçare, të shprehura në monedhën vendase (ALL). Interesi merret gjysëmjetor në një normë kuponi respektive prej 5.45% (5-vjeçare) dhe 6.45% në 9.25% (10-vjeçare). Detajet e obligacioneve qeveritare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, duke treguar maturimin e tyre fillestar, vlerën e tyre të librave dhe vlerën e drejtë përkatëse në datën e raportimit, sipas llojit, paraqiten si më poshtë:

31 dhjetor 2017							
	<i>Vlera nominale</i>	<i>Primi</i>	<i>Zbritja e shtyrë</i>	<i>Interesi i përlogaritur</i>	<i>Vlera e amortizuar</i>	<i>Diferenca e rivlerësimit</i>	<i>Vlera e drejtë</i>
60 muaj	99,000	-	-	794	99,794	52,776	99,794
120 muaj	158,200	26,918	(1,363)	5,787	189,542	24,657	189,542
	257,200	26,918	(1,363)	6,581	289,336	77,433	289,336

31 dhjetor 2016							
	<i>Vlera nominale</i>	<i>Primi</i>	<i>Zbritja e shtyrë</i>	<i>Interesi i përlogaritur</i>	<i>Vlera e amortizuar</i>	<i>Diferenca e rivlerësimit</i>	<i>Vlera e drejtë</i>
60 muaj	-	-	-	-	-	-	-
120 muaj	-	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-	-

Derivate-Option shitje

Gjatë vitit 2017 Grupi ka blerë optionet e lidhura me dy obligacione qeveritare. Detajet e opsioneve janë paraqitur si më poshtë;

31 dhjetor 2017							
	<i>Data e blerjes</i>	<i>Vlera nominale</i>	<i>Monedha</i>	<i>Option Shitje</i>	<i>Norma e Kupunit</i>	<i>Data e lëshimit</i>	<i>Frekuenca e kuponeve</i>
120 muaj	27.10.2017	2,133,120	USD	41,596	2.25%	25.11.2016	6muaj
120 muaj	27.10.2017	2,552,640	EUR	43,395	0.50%	15.08.2017	12muaj
		4,685,760		84,991			

Vlera e drejte e opsioneve për shitje është e përafert me vlerën e tyre kontabel.

13 Letra me vlerë të vlefshme për shitje

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë të përbëra si më poshtë:

